Rruga Arbërit

GAZETË E PAVARUR. NR. 5 (37). MAJ 2009. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO

AURORA GROUP

PROJEKTIM - ZBATIM

koha kalon, cilësia mbetet

Autostrada Tirane - Durres, Km.9
Tel: +355 48 30 2046
Tel: +355 48 30 2040
www.auroragroup.com.al
e-mail: auroragroup@auroragroup.com.al

OPINION

Një kujtesë për Universitetin

Nga: **TEFIK SKERA** - FAQE 4

BOTIME

Optika e Schmitt-it për Skënderbeun

Nga: **XHAFER MARTINI** - FAQE 16



TRADITË

OXHAQET E DIBRËS

Nga: **MOISI MURRA** - FAQE 12

9 qershor, Skënderbeu vjen në Peshkopi

Festë në bulevardin kryesor

Kuvendi i Dibrës në Pallatin e Kongreseve

SHENIM

Të votojmë

Më 28 qershor janë zgjedhjet parlamentare, por gazeta nuk mori përsipër të propagandonte asnjërën palë, pasi me periodicitetin aktual, nuk ruan dot pavarësinë e saj. Por, duke qenë të bindur se zgjedhjet parlamentare janë të rëndësishme për të ardhmen e vendit, na lind detyrimi moral të bëjmë një thirrje: Shkoni në zgjedhje dhe votoni!

Por, përpara se ta bëni një gjë të tillë, shikoni mirë programet e partive politike. Shikoni mirë përfaqësuesit e tyre. Bisedoni me to, dëgjojini ato, por edhe i pyesni për zgjidhjen e problemeve dhe halleve tuaja, të cilat nuk janë të paktë, kudo që jeni.

Mbi të gjitha, pyesni kandidatët për deputet mbi disa çështje themelore, të cilat janë parësore për qarkun e Dibrës. Pyesni ata për Rrugën e Arbërit dhe mbani shënim. Pyesni ata për qëndrimin që kanë mbi Skavicën, dhe mbani shënim. Pyesni ata mbi të ardhmen e minierës së Bulqizës, dhe mbani shënim. Pyesni ata mbi pasuritë kombëtare që mban qarku dhe mbani shënim. Në fund vendosni të votoni! Sepse vetëm kështu nuk lini pakicën e derisotme që ka votuar të sundojë mbi ju, por jeni Ju që keni vendosur për të ardhmen! Dhe zgjedhja juaj, sido që të jetë, ju bën më të përgjegjshëm në të ardhmen. Edhe në qoftë se gaboni njëherë, herën tjetër do zgjidhni kandidatin e duhur.



RAKIP SULI:
"...Ndjehesha shumë i lumtur që mblidheshin dibranët në Pallatin e Kongreseve për të festuar fillimin e Rrugës së Arbërit, e cila ju ka munguar me vite Dibranëve. Por më në fund qeveria Berisha po e bën realitet këtë ëndërr... Kjo rrugë nuk do sjellë vetëm bashkimin e Dibrës me Tiranën, jo vetëm zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit, zhvillimin kulturor, por edhe një lidhje me Maqedoninë dhe Kosovën. Sonte së bashku bëjmë këtë festë të madhe që na afron, por edhe që na bashkon.

SOKOL OLLDASHI:
Brenda këtij viti do tenderohen tre lote të tjera nga Bulqiza deri të Ura e Vashës dhe një lot nga Tirana drejt urës së Brarit...Sot nuk besoj të flitet më nëse është Rruga e Arbërit apo nuk është rruga e Arbërit. Rruga e Arbërit avancon çdo ditë, është tashmë një realitet dhe unë kam pasur fatin të jem ministër i Punëve Publike, kur kryeministri i këtij vendi ka marrë vendimin politik për ta ndërtuar këtë rrugë, pavarësisht kostos financiare. Nuk është e vetmja që po bëjmë në trevën e Dibrës.

BUJAR KAPEXHIU:
"Ky takim do mbetet i paharruar në historinë e ndërtimit të kësaj rruge të madhe, e cila do të sjellë integrimin e Dibrës dhe rajonit drejt proceseve integruese evropiane. Të gjithë së bashku jemi një impuls gjingand drejt realizimit të kësaj ëndrre. Rruga e Arbërit ka sot të shtruar në tabanin e saj mendjen dhe shpirtin e çdo dibrani, duke u bërë kështu traseja më e shkurtër, më e gjerë, më e fortë, më e bukur e përshëndetjes sonë, e përqafimit, e projekteve, e bashkëpunimit dhe realizimit të ëndrrave të çdo dibrani.

SPECIALE NE FAQET 3,8,9

HISTORI

Kongresi që vuri themelet e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare për pavarësi

Nga: **SAKIP CAMI** - FAQE 6,7

Kongresi i Dibrës dhe Hafiz Ali Korça

Shkruar nga ABDYL YPI në vitin 1918 - FAQE 7

TRADITË

Çezmat që shuanin etjen dhe ndiznin dashurinë

Nga: **REXHEP TORTE** - FAQE 11

Posta e Rruga Arbërit


Gazetë e pavarur.
Nr. 4 (36). 1- 30 Prill 2009

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.

Redaksia u kujton bashkëpunëtorëve të saj, zotërinjve Ymer Keta, Isa Halilaj, Bernard Zotaj, Naim Plaku, Agron Tufa, Abdurahim Ashiku, Xhelal Roçi, Odise Plaku, Kujtim Boriçi, Ymer Stojku etj, se shkrimet e tyre, për arsye vendi nuk janë botuar në këtë numër.
Ato do të botohen në numrat e ardhshëm të gazetës "Rruga e Arbërit".

Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

Këshilli Botues:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Bashkëpunuan në këtë numër:
Rexhep TORTE,
Xhafer SEITI
Naim PLAKU
Vesel HOXHA
Sakip CAMI
Tefik SKERA
Marius DOBRESCU
Moisi MURRA
Zaim ELEZI
Xhafer MARTINI
Mevlud BUCI
Shemsi DACI
etj.

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Dibër e Madhe - Filloi rikontruksioni i **rrugës së Strugës**

Kryeministri i Maqedonisë Nikolla Gruevski përuroi fillimin e punimeve

Në vendin Llukovë që ndodhet në mes të segmentit rrugor Dibër e Madhe -Strugë, më 26 maj, në pranië e Argëtim Fidës, kyetarit të komunës dhe Nizamedin Papraniku, kryetar i Këshillit të Komunës Dibër e Madhe, të Ramiz Merkos, kryetarit të Komunës së Strugës, për faqësuesve të Drejtorisë së rrugëve rajonale dhe të ftuarve tjerë, Nikolla Gruevski , premieri i Maqedonisë, përuroi fillimin e punimeve të rikonstruksionit të këtij segmenti rrugor.

Kryeministri Gruevski para të pranishëmve, deklaroi se: "Ky drejtim rrugor është e vetmja lidhje mes Strugës dhe Dibrës që e shfrytëzojnë banorët e kësaj ane dhe që ka trafik të intensifikuar. Dëmtimi i kësaj rruge në të kaluarën paraqiste vështirësi gjatë transportit dhe zvogëlim të sigurisë së udhëtarëve. Në këtë segment rrugor do të shtrijmë 24 kilometra asfalt, për çka Qeveria e Maqedonisë ka planifikuar 3 milionë e 300 mijë euro. Pas kësaj do të vazhdojmë me rikonstruksionin e pjesës tjetër të kësaj rruge, duke bërë rikonstruksionin e tërësishëm. Punimet do të përfundojnë pas gjashtë muajve dhe ky rajon do të ketë një rrugë që do të ofron kushte më të mira për vozitësit dhe rritje të sigurisë në komunikacion. Me rikonstruksionin e rrugës Strugë- Dibër, shtoi ai, vazhdon realizimi i projektit për rikonstruksioni dhe rehabilitimi i 11 rrugëve rajonale. Qeveria para zgjedhjeve premtoi investime



të mëdha strategjike në shtatë vitet e ardhshme në infrastrukturë. Dëshiroj të theksoj se në strategjinë e qeverisë për zhvillimin afatgjatë të vendit janë parashikuar projekte për ndërtimin, rikonstruksionin dhe revitalizim e një numri të madh të rrugëve rajonale e lokale, që janë me rëndësi thelbësore për ekonominë, biznesin dhe për qytetarët që i shfrytëzojnë. Këto janë projekte strategjike infrastrukturore të Qeverisë së Maqedonisë në komunikacionin rrugor, hekurudhor, në arsim, energjetikë, sport, ekologji dhe në fusha tjera, tha Gruevski.

Me këto investime do të zgjidhen problemet me dekada të qytetarëve që udhëtonin në rrugë të vjetra e të shkatërruara. Me ndërtimin e rrugëve të reja do të lidhen shumë rajone që deri tani nuk ishin të lidhura, do të sigurohet qarkullim më i shpejtë i njerëzve dhe mallrave dhe siguri më e madhe në rrugë. Do të hapet front pune për shumë ndërmarrje ndërtuese në vend, që është me rëndësi në këtë krizë të fuqishme globale në botë, tha në fund kryeministri Nikolla Gruevski.

> Të rikujtojmë se nga Dibra e Madhe për në Strugë, 24 kilometrat e rrugës deri në Llukovë, që kur u ndërtua kjo rrugë para më shumë se katër dekadave janë me gjerësi vetëm 5 metra, gjë që dëshmon egërsinë moniste ndaj Dibrës së Madhe, dibranëve dhe banorëve të kësaj ane. Shpresojmë që kësaj radhe do të korrigjohet kjo padrejtësi.

Të rikujtojmë se nga Dibra e Madhe për në Strugë, 24 kilometrat e rrugës deri në Llukovë, që kur u ndërtua para më shumë se katër dekadave janë me gjerësi vetëm 5 metra, gjë që dëshmon për egërsinë moniste ndaj Dibrës së Madhe, dibranëve dhe banorëve të kësaj ane. Shpresojmë që kësaj radhe do të korrigjohet kjo padrejtësi e vrazhdë.

Rexhep TORTE





"Ne nuk jemi për muranë"

Me datën 07/05/2009, në qytetin e Peshkopisë u realizua montazhi muziko-letrar nga nxënës të klasë së nëntë të shkollës nëntëvjeçare "Demir Gashi" me temë: "Ne nuk jemi për muranë". Ky aktivitet kishte për qëllim të sensibilizonte qytetarët për ndalimin e gjakmarrjes mbi fëmijët.Në këtë aktivitet morën pjesë prindër, mësues e nxënës. Një ftesë e veçantë nga organizatorët ishte bërë për zonjën Flora Brovina, mjeke e njëkohësisht dhe deputete në Parlamentin e Kosovës.Prania e saj në këtë aktivitet ishte një ngjarje e madhe për të gjithë kolektivin e shkollës "Demir Gashi". Morën pjesë zv/ministri i kulturës zoti Eqerem Spahiu,kryetari i bashkisë së qytetit Peshkopi zoti Ilir Krosi.Aktiviteti ishte pregaditur nga vetë drejtoria e shkollës nën përkujdesjen direkte të mësuesve Emrie Skuka,Genci Lleshi e Avni Lala.U vlerësua shumë materiali letrar si dhe kënga me tekst të Naim Plakut e kompozim të Përparim Tomçinit "Jo hakmarrje" Në fund nga organizatorët u falenderua në veçanti biznesmeni dibranë Musa Rriçku, që falë kontributit të tij financiar, u bë i mundur ky aktivitet mjaft domethënës.

BËHUNI PJESË E GAZETËS!

E-mail: rrugaearberit@gmail.com. Tel. 069 20 68 603 / 068 31 19 232
www.**dibra**.org



FOTO: B.KAROSHI

"Dibran dhe miq të Dibrës, motivi për tu mbledhur dibranët sonte në këtë sallë të madhe, për herë të parë, ishte i madh dhe mjaft i rëndësishëm. Të promovojmë rrugën e të parëve tanë, Rrugën e Arbërit... Ky është Kuvendi i Dibrës në Pallatin e Kongreseve."

"Kjo mbrëmje nuk ka heronj, as kompani që e mbështesin, apo të tregojmë me dorë protagonistë, por të jemi të sinqertë, nisma dhe ideja e parë ka emrin e një djali të suksesshëm Dibran në Tiranë, Rakip Suli, i cili me dëshirën e tij të mirë dhe shpirtin e tij fisnik, vendosi ta kthejë sonte këtë sallë në një odë të madhe Dibre, duke u bërë kështu "de fakto" një ambasador i lidhjes mes njerëzve dhe promovimit të vlerave më të mira të komunitetit dibran.
Kjo veprimtari ka edhe mbështetjen e miqve të tij, Musa Ricku, Zabit Muda, Përparim Golli, Xhetan Ndregjoni dhe Bilbil Lleshi".

"RRUGA E ARBERIT, RRUGA QE AFRON"

Kuvendi i Dibrës në Pallatin e Kongreseve

Nga: **SHAQIR SKARRA**

Para pak kohësh kur në një nga sallat e Akademisë së Arteve u bë promovimi i diskut të këngëtares dibrane Vera Laçi, "Oj Xhemile", në diskutimin e tij biznesmeni dibran Rakip Suli tha: "Është e vogël kjo sallë për këngët e vallet dibrane, për folklorin dibranë, për artistët dibranë. Duhet Pallati i Kongreseve për aktivitete të dibranëve". Siç duket, Rakipi e kishte pasur idenë në kokë herët për këtë aktivitet. E pikërisht, më datë 11 maj 2009, qysh në orën 6 pas dite sheshi "Nënë Tereza"ishte mbushur plot. Kishin ardhur nga të gjitha anët e prisnin vetëm orën 19 e 30 minuta që të vërshonin në Pallatin e Kongreseve. Sonte kjo godinë madhështore, më e madhja në vend, ishte "pushtuar" nga dibranët por jo vetëm kaq. Kishte edhe të ftuar të tjerë; akademikë, intelektualë, folkloristë e studiues të të gjitha fushave, miq dhe të afërm të dibranëve. Ishte i pranishëm Ministri i Transporteve z. Sokol Olldashi, këshilltarët e kryeministrit për arsimin dhe ekonominë, z. Myqerem Tafaj e Selami Xhepa, deputetët Sali Shehu, Rahim Kaleci, Idriz Xhumara e Albert Faruku, Prefekti i Qarkut Dibër Xhafer Seiti, kryetarët e bashkive dhe komunave të qarkut të Dibrës, drejtori i Policisë së Shtetit, Ahmet Prenci dhe plot të tjerë. Salla u mbush dhe shumë veta qëndruan në këmbë.

Dy prezantuesit e këtij spektakli, dy emra të njohur, dy dibranë ishin të parët që ngjitën skenën, gazetari i njohur sportiv Defrim Methasani dhe studentja e Akademisë së Arteve, Ejona Torba, e njohur për prezantimin e Odës Dibrane në vite.

"Dibran dhe miq të Dibrës, nisi prezantimin e spektaklit Defrim Methasani, motivi për tu mbledhur dibranët sonte në këtë sallë të madhe, për herë të parë, ishte i madh dhe mjaft i rëndësishëm. Të promovojmë rrugën e të parëve tanë, Rrugën e Arbërit por nëpërmjet artit, kulturës dhe folklorit të Dibrës. Kjo rrugë është rruga që afron njerëzit, kulturat, zhvillimin dhe integron komunitetin dibranë më shpejt drejt metropolit dhe Europës. Ky është Kuvendi i Dibrës në Pallatin e Kongreseve. Jemi mësuar në programe të tilla, që të niset me himnin kombëtar, dhe që domosdo të ngjall mjaft interes. Por sonte për kënaqësinë e të gjithë dibranëve, por dhe miqve të tyre, për herë të parë në këtë skenë, promovohet himni i Djelmënisë Dibrane. Ky himn është shkruar nga Haki Sharofi në vitin 1923 dhe kompozuar nga Sami Gonxhe dhe për herë të parë është kënduar në Lanë-Lurë në vitin 1923. Sonte mundësohet nga një grup i njohur, mes të cilëve janë edhe dy artistë dibranë Isak Shehu dhe Sokol Saraçi.

Tenori Kastriot Tusha ngriti skenën në këmbë me interpretimin e mrekullueshëm që i bëri "Djelmnisë Dibrane"

Më pas ngjiti skënen regjisori dibran Bujar Kapexhiu: "Mirmrama, a jeni majr", përshëndeti sallën e mbushur si kurrë më parë, dhe tha: "Ky takim do mbetet i paharruar në historinë e ndërtimit të kësaj rruge të madhe, e cila do të sjellë integrimin e Dibrës dhe rajonit drejt proceseve integruese evropiane. Të gjithë së bashku jemi një impuls gjingand drejt realizimit të kësaj ëndrre. Rruga e Arbërit ka sot të shtruar në tabanin e saj mendjen dhe shpirtin e çdo dibrani, duke u bërë kështu traseja më e shkurtër, më e gjerë, më e fortë, më e bukur e përshëndetjes sonë, e përqafimit, e projekteve, e bashkëpunimit dhe realizimit të ëndrrave të çdo dibrani.

Historia kombëtare është e cunguar pa historinë e Dibrës.

"Dibra është krahina me më shumë histori se çdo vend tjetër. Sa e sa ngjarje me rëndësi kombëtare e historike fillimin dhe përfundimi e kanë në Dibër ose shumë ngjarje të tjera kanë pasur protagonistë dibranët, ngjarje të cilat kishin të bënin me fatin e atdheut."

Më pas Kapexhiu foli për vlerat kulturore, etnografike të Dibrës, të cilat janë në fondin e artë të kulturës shqiptare.

"Krahina e Dibrës ka shumë gjëra të mëdha. Ka të Parën Dibrën e Madhe. Ka malin më të lartë në Shqipëri, Korabin. Dibra ka lumin më të gjatë në Shqipëri, Drinin e Zi. Dibra ka figurën më të madhe të kombit shqiptar, dibranin nga Sina, Heroin Kombëtar, Gjergj Kastriotin. Dibra ka Kuvendin e madh të Alfabetit".

"Në 60 vjet kam shkuar vetëm një herë në Dibër, bën humor Kapexhiu, por me rrugën e re, në një vit do shkoj 60 herë".

"Duke qenë i bindur se qeveria do e mbajë fjalën dhe do e përfundojë shumë shpejt Rrugën e Arbërit, përfundoi Kapexhiu, urime për rrugën e re".

Në skenë ngjitet Qerim Sula. Ai kishte anuluar një koncert recital për CD e tij të re, për t'iu bashkangjitur festës së dibranëve në Pallatin e Kongreseve. Kishte kohë spektatori dibranë pa e parë këngëtarin virtuoz, këngëtarin që me zërin e tij kumbues ka ngritur në këmbë sa e sa veta në skena të ndryshme të botës. E këtë natë, si një surprizë për spektatorin e zgjedhur Qerimi këndoi këngën për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, me tekst të Naim Plakut e muzikë të Përparim Tomçinit.

(Vijon në faqen 8-9)

RAKIP SULI:
"Para se të ngjisja këto shkallë pata emocione. Por, nga ana tjetër ndjehesha shumë i lumtur që mblidheshin dibranët në Pallatin e Kongreseve për të festuar fillimin e Rrugës së Arbërit, e cila ju ka munguar me vite Dibranëve, tha ai. - Por më në fund qeveria Berisha po e bën realitet këtë ëndërr të Dibranëve. Kjo rrugë nuk do sjellë vetëm bashkimin e Dibrës me Tiranën, jo vetëm zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit, zhvillimin kulturor, por edhe një lidhje me Maqedoninë dhe Kosovën. Ju falënderoj të gjithëve që sonte së bashku bëjmë këtë festë të madhe që na afron, por edhe që na bashkon.



FOTO: B.KAROSHI

Universiteti i Dibrës do të ishte jo vetëm një komplimentues i munguar i tërë zhvillimit të arsimit në Shqipëri, por njëkohësisht ai do të ishte edhe një konkurrues i denjë që do të kontribuonte suksesshëm në nxitjen e zhvillimit të alternativave më të mira në ekonomi, kulturë, histori, shkencë e të tjera në mbarë hapësirat shqiptare e më gjerë.

"Kur do të shkollohet Dibra?"

Një kujtesë për Universitetin e Dibrës

Nga **TEFIK SKERA**,
Toronto Kanada

Ideja e hapjes së një Universiteti në Dibër ka qenë një nga lajmet më të shumëpritura të botuar nga gazeta "Rruga e Arbërit". Çuditërisht, në 3-4 numrat e fundit, asnjë lajm nuk është dhënë më për këtë institucion kaq të rëndësishëm. Nuk e di se çfarë ka ndodhur në të vërtet, por shpresoj se ajo nuk ka qenë thjeshtë një ëndërr sa për të zbavitur mendjen e dibranëve. Nuk kam ndërmend të shpjegoj këtu rëndësinë e hapjes së Universitetit në Dibër, pasi atë e di kushdo tashmë. Por në themel të përqasjes së nevojës së hapjes së universitetit, qëndron në radhë të parë dëshira shumëshekullore e dibranëve në të dyja anët e kufirit, për të qenë sa më shumë të arsimuar. Hapja e Universitetit do të ndryshonte përgjithmonë raportet midis dëshirës dhe mundësisë për tu shkolluar, duke i thënë kështu një shtytje të fuqishme ngritjes së standardeve arsimore të Dibrës, zonave përreth e mbarë Shqipërisë. Dibra ka potenciale të mjaftueshme njerëzore për ta ngritur emrin e universitet në lartësitë e kohës në mbarë trevat shqiptare dhe shprehja "Ka mbaruar shkollën e Dibrës" nuk do ti referohet vetëm zgjuarsisë natyrale të dibranëve, por edhe nivelit bashkëkohorë të Universitetit. Universiteti i Dibrës do të ishte një shtysë e gjithanshme e zhvillimit ekonomik e kulturor dhe do të bënte të mundur që niveli i përgjithshëm arsimor të barazohej me atë të zonave të tjera të vendit. Universiteti i Dibrës do të shërbente edhe si një urë e fuqishme ndërlidhje midis shqiptarëve në mbarë trojet shqiptare e posaçërisht të atyre në Maqedoni, duke synuar një objektiv strategjik atë të ngritjes së bashkëpunimit kombëtar të të gjithë shqiptarëve në Ballkan në nivelin e duhur, për të siguruar një nivel të ndërgjegjes kombëtare afatgjatë e të qëndrueshëm, në nivelin që e kërkon koha dhe kjo bëhet më e domosdoshme veçanërisht nën rrjedhat e kufijve virtual të së ardhmes. Universiteti i Dibrës do të ishte jo vetëm një komplimentues i munguar i tërë zhvillimit të arsimit në Shqipëri e mbarë trevat shqiptare, por njëkohësisht ai do të ishte edhe një konkurrues i denjë që do të kontribuonte suksesshëm në nxitjen

Dibra ka potenciale të mjaftueshme njerëzore për ta ngritur emrin e universitet në lartësitë e kohës në mbarë trevat shqiptare dhe shprehja "Ka mbaruar shkollën e Dibrës" nuk do ti referohet vetëm zgjuarsisë natyrale të dibranëve, por edhe nivelit bashkëkohorë të Universitetit.

e zhvillimit të alternativave më të mira në ekonomi, kulturë, histori, shkencë e të tjera në mbarë hapësirat shqiptare e më gjerë.

Dibranët duhet të ballafaqohen me realitetin, të korrigjojmë ndërgjegjen tonë disi të cunguar në drejtim të edukimit universitare mbarë shoqërorë dhe ta shikojmë atë si një domosdoshmëri të kohës dhe si një alternativë të fuqishme të ngritjes së mirëqenies ekonomike e kulturore mbarë qytetare. Gjithashtu, ne duhet të kuptojmë se falë pasurive natyrore të pashtershme kemi kontribuar për shumë vite me radhë në zhvillimin ekonomikë të mbarë vendit dhe kërkesa për hapjen e universitet do të ishte një kërkesë minimale për të çuar në vend drejtësinë e munguar. Hapja e universitetit do ndikonte fuqishëm në ndryshimin e tendencave të dibraneve për të migruar drejtë rajoneve të tjera për një mundësi më të mirë për punësim e për të shkolluar brezin e ri.

Fushata elektorale për zgjedhjet e legjislaturës së ardhshme tashmë ka filluar dhe dibranët duhet të vënë çështjen e hapjes së Universitetit si një nga çështjet kryesore, duke ju kërkuar vota mbledhësve të çfarëdo llojë partie me shumë forcë hapjen e këtij Universiteti. Hapja e Universitetit do të ishte preambula e fushatës elektorale të çdo koalicioni partiak dhe suksesi i tij. Edhe Shoqata e Intelektualëve Dibranë do të duhej të ishte shumë më aktivë në këtë drejtim dhe do të duhet të kishte nxjerrë si platformën mbështetëse të vetme në këtë fushatë elektorale çështjen e hapjes së Universitetit. Në këtë kontekst, do të dëshiroja t'ju bëja thirrje të gjithë kandidatëve (disa i njohë edhe personalisht) për në legjislaturën e ardhshme, që në qoftë se duan votat e dibranëve tashmë e kanë në dorë çelësin: të premtojnë jo me fjalë boshe por me vepra hapjen e sa më të shpejtë të këtij Universiteti. Hapja e Universitetit do të shënonte një pikë kulmore në historinë e Dibrës dhe dibranët në të dyja anët e kufirit do të sakrifikojnë gjithçka që universiteti të ngrihej e të forcohej shumë shpejtë.

Dibranët duhet të ballafaqohen me realitetin, të korrigjojmë ndërgjegjen tonë disi të cunguar në drejtim të edukimit universitare mbarë shoqërorë dhe ta shikojmë atë si një domosdoshmëri të kohës dhe si një alternativë të fuqishme të ngritjes së mirëqenies ekonomike e kulturore mbarë qytetare.

Kur do të shkollohen dibranët? Do të kisha dashur të sillja këtu një kujtesë të së kaluarës por që në fakt zbërthen nevojën e kahershme të hapjes së një Universiteti në Dibër.

Ishte fillimi i viteve 80, dhe si atëherë gjatë pushimeve të verës punonim në ndërmarrjen shtetërore të Shumbatit. Në një ditë të nxehtë korriku ishim mbledhur të gjithë ne, nxënësit e shkollave të mesme e të larta dhe, po bënim pushimin e drekës. Bashkë me ne ishte edhe një burrë i moshuar që përkujdesej për grupin e nxënëseve. Si gjithmonë, gjatë pushimit të drekës burri i moshur do të bënte pyetje nga më të ndryshmet për të parë se si nxënësit do të përgjigjeshin. Më origjinën e tij nga zona e Zallë Dardhës (me sa më kujtohet) pyetjet nuk ishin të drejtpërdrejta, por ato ishin pyetje të urtësisë dibrane: domethënë, duhej te lexonim në mes fjalëve që të kuptonim përmbajtjen reale të pyetjes. Pyetja e asaj dite ishte: "Kur do të shkollohet Dibra?" Ne si nxënës të shkollave të mesme tonim të thoshim idetë tona se "Dibra është e shkolluar tashmë me shumë shkolla e nxënës në të katër anët". Plaku rrinte e dëgjonte diskutimet tona, por pa dhënë asnjë përgjigje. Shpresuam se i shpjeguam plakut të mençur se Dibra ishte e shkolluar, por pasi na pa të gjithëve në sy, përsëri pyeti: "Kur do të shkollohet Dibra?" Atëherë e kuptuam se pyetja e plakut nuk ishte e thjesht siç e menduam në fillim. Diçka me filozofike ishte në mendjen e tij. Pa e zgjatur më shumë plaku shtoi: "Sa djem e vajza janë në shkollë të mesme në secilin nga katundet që ne vinim. Po me shkollë të lartë? Sa mësues nga zona juaj japin mësim në shkollën e mesme tuajën?" Duke sjellë faktet rezultonte se shumë mësues nuk ishin në fakt banor të zonave dhe disa prej tyre vinin që nga larg, Saranda, Gjirokastra, Lushnja, Fieri, Berati, etj. Pas diskutimeve, gjithashtu doli një fakt i pamohueshëm, jo vetëm atëherë por edhe sot - shumë pak vajza ka në shkolla të mesme dhe akoma më pak në universitete. Atëherë plaku na u drejtua sërish neve: "Kur unë pyeta se a është e shkolluar Dibra, nuk pyeta se a dimë të numërojmë deri në një mijë, por se sa të rinj e të reja kanë mbaruar universitetin ose e ndjekin atë". Duke parë gjendjen ekonomike të Dibrës në atë kohë, vetë mentalitetin jo shumë inkurajues për të shkolluar vajzat si dhe faktin se kushtet ekonomike për shkollim me arsim të lartë nuk kanë qenë shumë të favorshme për Dibrën - arritëm në konsensus se Dibra do të shkollohet vetëm atëherë kur të kemi universitetin tonë. Plaku na pa në sy dhe tha: "Ndoshta kjo është fjala më e mirë që kam dëgjuar në jetën time, por e kam të vështirë ta besojë ose kjo nuk do të ndodhi gjatë kohës sime." Dhe duke tundur kokën shtoi: "E pra, djem e vajza, atëherë kur Dibra do të ketë Universitetin e vet, atëherë edhe unë besojë se do të shkollohet Dibra".

Dhe atë ide se si do të shkollohet Dibra, të mbështetur nga prefekti i tanishëm i Qarkut të Dibrës duhet ta bëjmë të gjallë dhe ta bëjmë realitet. Kjo kërkon që dibranët të ngrihen mbi interesat individuale, të bashkohen dhe me punë e zgjuarsi ta ndërtojnë universitetin sa më parë.

Koha ka ardhur.

Maj, 2009

Me shkas

Dibra e Madhe kërkon nga Universiteti Tetovës hapjen e një fakulteti

Kohëve të fundit mediat në Maqedoni in formuan për vendimin e Qeverisë së Maqedonisë që në vitin shkollor 2009-2010 nga Universiteti Shtetëror i Tetovës do të bëhet dispersioni i Fakultetit Juridik dhe i Administrim Biznesit në Shkup e Kërçovë, ndërsa në Strugë do të dispersohet Fakulteti Ekonomik.

Në vitin 2006 mediat në Maqedoni njoftuan për vendimin e USHT-së, që në Strugë të hapën Institutin për Ekologji dhe teknologji.

Në vitin 2007 USHT hapi Fakultetin e Arteve Aplikative në Gostivar, ndërsa dha lajmin se do të hapet edhe një fakultet në Kumanovë.

Çdo hapje e fakulteteve është punë e nderuar, por lind pyetja pse Dibra e Madhe mbetet e lënë pas dore dhe pse nuk ka asnjë nismë apo njoftim konkret që edhe në këtë qytet të hapet ndonjëri nga fakultetet e USHT-së.Kjo aqë më tepër sepse në vitin 1994 Dibra e Madhe bashkë me Tetovën dhe Gostivarin ishte nënshkruese e Marrëveshjes për themelimin e Universitetit të Tetovës.Asokohe vënia e nënshkrimit të këtillë nuk ishte aspak e lehtë por lypte guxin e sakrificë.

Një nga premtimet kur u nënshkrua Marrëveshja për themelimin e UT-së, ishte edhe hapja e fakultetetit pedagogjik në Dibër të Madhe . Disa vite më vonë në Dibër të Madhe u zhvilluan edhe provimet pranuese për studenët e fiskulturës dhe flitej se së shpejti këtu do të hapej edhe Fakulteti i Fiskulturës, por derisot asgjë nuk është realizuar.

Dibra e Madhe ka kushte ideale për hapjen e fakultetit të fiskulturës, ose të ndonjë fakulteti tjetër.Ka vende hapësira për ndërtimin e terreneve sportive, ka lumin Radikë, Liqenin e Dibrës , ujin e banjave termominerale, të gjitha mundësitë për ndërtimin e pishinave sportive për t'i shfrytëzuar gjatë tërë vitit.Ka liqenin për sportet ujore, ka terrene për zhvillimin e sportit dimëror.Për hapjen e ndonjë fakulteti mund të shfrytëzohet edhe ish kazerma ushtarake me godinat dhe ambientet e saj shumë të volitshme.

Dibra e Madhe meriton kujdes dhe vëmëndje më të madhe nga të gjitha strukturat shqiptare vendore, qeveritare dhe shtetërore në Maqedoni e më gjerë, qoftë për historinë e saj të begatë e të përgjakshme për çështjen mbarëkombëtare shqiptare,qoftë për praninë e pishtarëve dibranë të arsimit në të gjitha trojet shqiptare në Maqedoni.

Dibra e Madhe sot ka mbetur e alivanosur dhe dita ditës po braktiset nga të rinjtë, të cilët të pashpresë janë të detyruar të largohen nga vendlindja. Hapja e një fakulteti të USHT-ë së në Dibër të Madhe mbase do ta plotësonte borxhin ndaj këtij qyteti dhe do të ringjallte shpresën për rimëkëmbje në të gjitha fushat e jetës.

Liberalizimi i vizave mes Shqipërisë e Maqedonisë,fillimi i punimeve për ndërtimin e Rrugës së Arbërit, kur distanca mes Tiranës dhe Dibrës së Madhe do të jetë vetëm 72 kilometra, ofron mundësinë që në Dibër të Madhe të arrijnë më lehtë e më shpejtë studentë dhe pedagogë nga Maqedonia dhe Shqipëria.

Ky tekst le të shërbejë si nxitje për Universitetin Shtetëror të Tetovës që t'i kthejë sytë edhe nga Dibra e Madhe , e cila nënshkrimin e saj e ka vënë në themelet e themelimit të këtij tempulli shqiptar të dritës së diturisë.

Rexhep TORTE

Për opinione dhe komente mund të na shkruani në adresën: "rrugaearberit@gmail.com". Tel. 00355 4 22 33 283.
OPINIONET DHE KOMENTET E BOTUARA NUK SHPREHIN DOMOSDOSHMËRISHT QËNDRIMIN E REDAKSISË

analizë

Një vështrim i Prefektit të Dibrës mbi gjendjen ekonomike globale dhe vështrimin konkret mbi arsimin në Dibrës. Konkluzioni: "Një mësues pa personalitet apo me moral të cunguar i sjell edukimit një dëm të pallogaritshëm"

Arsimi duhet të parandalojë krizat



Nga: XHAFER SEITI
PREFEKT I QARKUT DIBER

(Vijon nga numri i kaluar)

Ndër problemet më shqetësuese për arsimin do të veçoja mungesën e laboratorëve mësimore në shkollat e të gjitha cikleve, gjë e cila kërkon planifikim dhe investim të veçantë. Gjykoj se duke u marrë më tepër me ndërtime e rikonstruksione, sikur është harruar elementi më i domosdoshëm i thellimit të punës shkencore në shkollë.

Ky investim fizik në shkolla me shuma të mëdha financiare sa i shërbeu qëllimit, është pyetja që vjen natyrshëm.

Për eleminimin e këtyre mangësive mendojmë se rol të rëndësishëm luan rritja e punës së gjithanshme edukative të të gjithë faktorëve së pari me prindërit e më pas me fëmijët, bashkërendimi me organet e qeverisjes vendore, por dhe me O.J.Q – të.

Dëmi që i shkaktohet vendit nga mosmenaxhimi i mirë i problemeve të arsimit, është më i rëndë se çdo lloj veprimtarie tjetër. Por kur të kuptohet kjo nga shumëkush, atëhere do të jetë vonë e anafalbetizmi do të jetë ulur kembëkryq.

Faktor pengues në ecurinë e shkollës e procesit mësimor në tërësi, është dhe mungesa e mësuesve me arsim përkatës.

" Nderi" që mund t'i bëhet një personi duke e punësuar në arsim në mënyrë të pamerituar, thjesht për t'i gjetur vend pune, kthehet në bumerang jo vetëm për nxënësit dhe prindërit e tyre, por për gjithë shoqërinë.

Po çfarë mendoj se duhet bërë në këtë drejtim:

Lëvizja e lirë e njerëzve dhe bashkë me ta e mësuesve vazhdon.Ndërsa deri ne vitin 2000 mesatarisht largoheshin nga qarku i Dibrës 150 mësues të profilizuar në vit, më pas ky numër ka rënë, por gjithesesi lëvizje ka dhe pasojat janë krijuar e po rëndojnë " në kurrizin" e arsimit.

Në arsimin e mesëm mësuesit ngurojnë të punojnë, sepse paga nuk është stimuluese në raport me arsimin 9-vjeçar, problem i cili do të zgjidhej po qe se Qeveria do të ndërhynte për këtë stimulim akoma më të thelluar në lëndë të veçanta si: matematikë, fizikë, kimi, biologji etj., sipas shkallës së vështirësisë.

- Diferencimi në pagë i mësuesve që mund të shprehin dëshirën të punojnë në rrethet e Veriut, do të ishte njëra nga zgjidhjet.

Domosdoshmëri është thellimi i punës kualifikuese si nga Zyrat Arsimore ashtu dhe nga drejtoritë e shkollave.

Problemi do të merrte zgjidhje po qe se në qarkun e Dibrës, e konkretisht në Peshkopi, do të hapej një filial universiteti me ato profile për të cilat ka mangësi ky qark, kryesisht për mësuesi në profile të veçanta, ekonomik, apo profile të tjera të natyrave profesionale, veçanërisht bujqësore, blegtorale, teknimum minierash.

Përmendëm këto probleme jo në rolin e konstatuesit, por si drejtime edhe të punës sonë për të ndihmuar këtë sektor duke qartësuar se për gjithçka që nuk varet nga drejtoritë e zyrat arsimore, nga drejtoritë e shkollave, apo MASH, port ë gjithë kanë detyrat e tyre në radhë të parë duke vetëkuptuar rëndësinë që ka arsimi e më pas duke punuar, dhënë mendime e sugjerime se si mund të rregullohen shumë probleme në arsim.

Aktorët politikëbërës (ministër, qeveri, parlament) nxjerrion ligje, vendime, urdhëra, udhëzime. Këtyre u përgjigjet adminitrata sipas piramidës. Po ato shpesh janë të padiskutuara. Dhe si rezultat lindin pyetjet : sa është niveli i informacionit dhe njohurive të tyre? (zbatuesve). Mos vallë gjatë zbatimit të objektivave të qeverisë apo qeverive në fushën e arsimit ka përplasje me formalitetin?

Qarku i Dibrës është pjesë e Shqipërisë dhe Shqipëria pjesë e Planetit.

Shtrihet në zonën Verilindore të Shqipërisë.

Në juridiksionin e tij bëjnë pjesë rrethet Dibër, Bulqizë e Mat, ka 31 komuna, 4 bashki (Peshkopi, Bulqizë, Burrel e Klos, nga 6 qytete të emërtuara), qyteti i Krastës është emërtuar komunë dhe i bashkëngjiten dhe 8 fshatra, po kështu qyteti i Ulzës, të cilit i bashkëngjiten dhe 5 fshatra. Qyteti i Klosit është emërtuar bashki dhe ka në juridiksionin e tij 13 fshatra.

Në përbërjen e njësive administrative (komunave) janë 279 fshatra, numër i cili e rendit qarkun e Dibrës në vend të tretë pas qarkut të Elbasanit e Korçës.

Qarku kufizohet: Nga Lindja me kufi shtetëror të ish – Republikës Jugosllave të Maqedonisë,nga Perëndimi me Kurbinin, Krujën e Tiranën,nga Veriu me rrethin e Kukësit dhe Mirditës,nga Jugu me rrethin e Tiranës dhe Librazhdit.

Qarku ka 91 km kufi shtetëror me ish – Republikën Jugosllave të Maqedonisë, nga të cilat 15 km lumë, 9 km përrenj dhe 67 km kufi tokësor.

Pozita gjeografike: Qarku i Dibrës është vendosur ndërmjet:

- Gjërësi gjeografike Veriore 41^0 26, gjërësi gjeografike Jugore 41^0 54',gjatësi gjeografike Lindore 19^052',gjatësi gjeografike Perëndimore 20^0 39'

Ka një gjatësi vertikale (Veri – Jug) prej 62.9 km dhe një gjërësi horizontale (Perëndim – Lindje) prej 67.3 km.

Relievi rreth 80% është kodrinor dhe malor.

Lartësia mbi nivelin e detit është nga minimalja 70 m (në zonën e Shkopetit), në maksimalen 2751 m (maja e malit të Korabit).

Klima në Rajon është semikontinentale, me verë të thatë dhe dimër të ashpër. Temperaturat ekstreme lëvizin mesatarisht nga -13^0 gradë celsius deri në + 35 gradë celsius. Pjesa Jugperendimore që i përket rrethit te Matit ka klimë më të butë dhe ditë- rreshje më të larta se pjesa tjetër që u përket rretheve Dibër e Bulqizë. Mesatarisht ditë rreshjet në vit llogariten nga 90 deri me 105 ditë/vit.

1. Siperfaqja e njësive administrative të Qarkut Dibër është 2432.3 kilometër katror e ndarë kjo sipas rretheve:

a) Rrethi Dibër 899.3 km^2
b) Rrethi Bulqizë 680.8 km^2
c) Rrethi Mat 852.2 km^2

Me këtë sipërfaqe qarku i Dibrës renditet i gjashti në Republikë pas qarqeve të Korçës, Shkodrës, Elbasanit, Gjirokastrës e Vlorës.

Njësitë me shtrirje më të madhe janë: Martaneshi 169.2 kilometër katror, Klosi 129.3 km^2, Zerqani 127.5 km^2, Lura 125.5 km^2, Komsia 99.7 km^2

Mirëmbajtja e shkollave duhet të kalojë kompanive private me kontratatë, ku të caktohen një sërë faktorësh dhe kushtesh, por në mënyrë të veçantë të theksohet cilësia e shërbimit dhe mirëmbajtjes

Sipërfaqja e qyteteve që përfshin qarku është 93.2 kilometër katror dhe konkretsiht Peshkopia 3.3 km katror, Bulqiza 8 km katror (dy qytetet – i vjetër dhe i ri dhe fshati Vajkal bashkuar me ta), Burreli 2.9 km katror, Klosi 21 km katror me gjithë fshatrat që përfshin bashkia, Krastë 40 km katror me gjithë fshatrat që formojnë komunën Martanesh, Ulëz 18 km katror së bashku me fshatrat që përbëjnë komunën.

Për vitin 2008 në qarkun e Dibrës u trajtuan me ndihmë ekonomike mesatarisht cdo muaj 12.853 familje(28%) me rreth 50000 frymë për të cilat shteti harxhoi 474 milionë e 600 mijë lekë për gjithë vitin, mesatarisht 3000 lekë për familje në muaj.

Numri i të papunëve vërtitet rreth 9500 persona në shkallë qarku, por këtu ka rezerva, pasi njerëzit regjistrohen si të papunë vetëm kur kanë nevojë për vërtetime që duhet t'i paraqesin në institucione të ndryshme.

Në çdo analizë dhe për çdo problem për të dalë në përfundime të sakta duhen pasur parasysh inputet: burimet (njerëzore, fizike, financiare), proceset e transforminit, outputet (produktet dhe shërbimet) si dhe feedbacku (vleresimi I rezultateve, vazhdimi, permiresimi, perfundimi).

Kujdesi në studimin dhe përcaktimin e tyre është thelbësor në nxjerrjen e përfundimeve korrekte.

Shtrohet Pyetja: Integrimin në Bashkimi Evropian, marrëveshjen e Stabilizim Asocimit kush do ta realizojë?! Dhe përgjigja vjen vetvetiu: Njerëzit me shkollë, kapitali njerëzor.

Në planetin njerëzor administrata po rrotullohet rreth arsimit, ekonomisë i janë marrë mendt e është kredhur në krizë. Ç'duhet të bëjmë me arsimin që të mos arrihet në marrjen e mendve të njerëzve dhe që të mos kalohet në superkrizë, në rrëmujë, revolta, pse jo dhe në revulucione?!

Outputet ndihmojnë mjedisin social, politik, ekonomik, fizik, të cilët sjellin ndryshime të mëtejshme dhe detyrimisht lindin kërkesa të reja për vazhdimësinë apo ndërprerjen (kthimin pas, qëndrimin në vend) të mirëqënies, zhvillimit, progresit.

Shkollat nuk ecin në një hap me zhvillimet teknologjike, të cilat sjellin kërkesa për zhvillim, pengojnë rrjedhimisht mirëqenien duke bërë të dukshme përplasjen midis autputeve të shkollave dhe zhvilimeve teknologjike.

Çdo prodhim në planet konsumohet sot nga të gjithë planetarët (zhvillimet teknologjike, interneti etj) dhe po kështu prodhimi material, shpirtëror, muzikor, estetik. Rinia po kalon drejt një globalizmi në mënyrën e të jetuarit punuarit, studimit, jetesës. në vitet '90 ne bëmë një hop dhe votuam Evropën, Amerikën. Ndaj dhe sot vlerat duhet të sjellin ndryshim dhe ky ndryshim të pasqyrohet në feedback.

Unë po shpreh mendimin tim për informacione që kam për pozicionin ku jam.

Outputet sjellin ndryshime dhe shfaqin kërkesa për ndryshime të mëtejshme duken te procesi i feedbackut.(Shqipëria po ndryshon edhe në arsim si në çdo fushë tjetër).

Burimet financiare (lekë), burimet njerëzore (mësimdhënie plus administratë), burimet fizike (ndërtesa plus pajisje) janë inputet.

Por shoqëria është e shqetësuar për prodhimin, rritjen e mirëqënies dhe jo aq për inputet. Interesat e shoqërisë, qoftë dhe ato të çastit, janë të ndryshme në përbërës të ndryshëm të saj, deri dhe në shtresa sociale të saj.

Pra problemi mund të shtrohet sipas tezës: Cila duhet të jetë cilësia e arsimit që do të sjellë rritjen e prodhimit për të cilin është e interesuar gjithë shoqëria, pjesët e segmentet e saj?!

Jo të gjithë anëtarët e një shoqërie janë të interesuar për shpenzime të larta në arsim nga Buxheti i Shtetit, donatorët, apo të ardhurat e vetëmenaxhueshme nga njësitë vendore. Pra jo të gjithë duan cilësi të lartë të arsimit.

Kjo bëhet më evidente dhe duhet pranuar kur na serviret fakti që nga 491 të zgjedhur këshilltarë në organet e qeverisjes vendore në 31 komunat e 4 bashkitë e qarkut Dibër 107 (21.8%) janë me arsim 8 vjecar, 266 (54.2%) me arsim të mesëm dhe 118 (24%) me arsim të lartë, apo kur në disa njësi vendore mbi 70% e këshilltarëve për të mos thënë më shumë janë me arsim 8 vjecar.

Një këshilli të tillë vendor me këtë nivel arsimor për veten e tij nuk ke si t'i kërkosh të shprehë mendime për arsimin në përgjithësi e inputet e tij në veçanti, aq më pak kur paralelisht me këtë nivel arsimimi shkon dhe administrate në disa njësi vendore ku mbizotëron në mënyrë absolute arsimi i mesëm.

Kjo sjell që disa duan rrugë, disa duan ujësjellësa, të tjerë shërbime shëndetësore, por dhe ritje pagash a shpërblimesh, ndonjëri mendon dhe për të bërë një udhëtim të organizuar me shpenzime të shtetit jashte shtetit.

Në morinë e problemeve organet e qeverisjes vendore e administratat e tyre duhet të përcaktojnë një strategji të qartë që të realizojnë shërbimet ndaj komunitetit të tyre për kërkesat dhe nevojat që kanë komunitarët e jo drejtuesit e administratës, apo këshillat vendorë dhe për të realizuar këto duhet produkt cilësor nga arsimi, sepse vetëm ky lloj produkti realizon sa sipër. Po a mund të përcaktojnë prioritete këshilla vendorë me nivelin arsimort që parashtruam?!. Dhe kjo kur pothuajse të gjitha subjektet politike kanë në rrdhët e tyre plot shtetas që në kontekstin që diskutojmë le t'i quajmë anëtarë partie që e kanë arsimin e lartë por nuk janë future në listat e kandidimit për të qenë anëtarë në këshillat përkatës që me të drejtë konsiderohen si parlamente vendore.

Shpesh takojmë probleme për institucionet arsimore për shkolla jo të mirëmbajtura, për mjedise jo funksionale, për mangësi që lindin gjatë punës së përditshme si dëmtime nga koha e vështirë, moti me shi e borë etj.

Në gjykimin tim mirëmbajtja e shkollave duhet të kalojë kompanive apo firmave private me kontratatë hapura apo kontrata të paplota ku të caktohen një sërë faktorësh dhe kushtesh, por në mënyrë të veçantë të theksohet cilësia e shërbimit dhe mirëmbajtjes. Kontrata të jetë e paplotë pasi nuk mund të parashikohet gjithçka për të ardhmen (nuk mund të parashikohet se mund të bjerë një çati, mund të shembet një mur e të tjera.

Arsimi emancipon, nxit qytetarët në qeverisje nëpërmjet votës, krijon stabilitet politik dhe qeverisje qëndrore të qëndrueshme. Të zgjedhurit përcaktojnë prioritetet e mundshme sipas rajoneve dhe zgjidhin problemet që dalin sipas kompetencave. Ndaj ngulmojmë të sqarojmë se gjendja e këshilltarëve në këto nivele arsimore krijon probleme, çon në regres e jo në progres, të shkolluarit, të arsimuarit sjellin evolucion dhe jo revolucion.

Mendoni për një moment se si në një këshill vendor ku nuk ka asnjë këshilltar me arsim të lartë dhe mbi 50% janë me arsim 8 vjecar e do të diskutojnë, arsyetojnë ligjërisht e votojnë për buxhetin e vitit. Miratimi i buxhetit në këtë rast degjeneron në " e votoj buxhetin se dua, apo nuk e votoj pasi nuk dua, kështu ma ka dhënë truri".

Në arsim duhet luftuar mediokriteti, sepse "prodhimi" i dalë nga arsimi, në të gjitha fushat parandalon ose jo një krizë të mundshme ekonomike, zgjidh ose jo probleme të mundshme sociale, janë e ardhmja e politikës, rrjedhimisht e qeverisjes.

Dhamë më lart shifra për investimet në arsim. Po kush na garanton se investimet në arsim nuk dështojnë? Cilët janë faktorët që na e garantojnë këtë? Po në qoftë se dështojnë ç'duhet të bëjmë kur dimë që nuk bëhet fjalë vetëm për arsimin, por për gjithë produktin që prodhon arsimi për të gjitha fushat? Si do t'i përballojnë e zgjidhin problemet brezat e ardhshëm kur dihet se krizat nuk janë tërmete që ndodhin menjëherë, por kanë disa faza, ato ndodhin siç është sot kriza konkrete ekonomike botërore që vërtet plasi sot, por ka vite që është gatuar.

Presidenti Barak Obama më 20 janar 2009 tha për arsimin: " Do të vendosim shkencën në vendin që meriton dhe do të përdorim mrekullit teknologjike për të rritur cilësinë e shëndetit me një kosto sa më të ulët. Do të shfrytëzojmë diellin dhe erën dhe tokën për të furnizuar makinat dhe fabrikatdhe do të transformojmë shkollat dhe universitetet për të qënë në një linjë me kërkesat dhe nevojat e epokës së re".

Unë mendoj që vertikalja e arsimit, krahas rezultateve të pamohueshme që ka arritur, duhet të shtrojë probleme për zgjidhje para ekonomistëve, psikologëve, shkencëtytarëve të teknologjisë së informacionit, sepse po shkohet drejt globalizmit botëror në të gjitha fushat. Edhe kultura, që mund të qëndrojë kombëtare, po globalizohet. Rinia këndon, kërcen, ushqehet, vishet, përvetëson, krijon një lloj si rinia amerikane, evropiane, aziatike, afrikane. E këtë e ka sjellë shkenca e teknologjisë së informacionit dhe dihet që sot po kalojmë drejt shoqërisë së informacionit.

Viruset e krizës ekonomike kanë lindur nga arsimi, pasi dihet që specialistët e ekonomisë janë product i arsimit. Përse ekonomistët nuk e parashikuan këtë krizë?!

Kriza ekonomike derisa paralizon ekonominë kalon në disa faza, të cilat zgjasin në vite dhe kjo jo vetëm nuk u parandalua, por as nuk u parashikua. Krizat nuk janë si tërmetet që ndodhin e veprojnë në harkun kohor të disa sekondave dhe nuk mund të parashikohen, por merren masa në ndërtime. Rezultati: tërmeti rrafshon ndërtesa dhe vret njerëz, ndërsa kriza rrënon ekonominë dhe varfëron njerëzimin.

Diber 17 Prill 2009

Manifestimi i Kongresit të Dibrës, do të mbahet me 23 dhe 24 korrik 2009 në Dibër të Madhe dhe evenimentet kryesore do të mbahen në ambientet e Qendrës për Kulturë

Dibër e Madhe - U themelua Këshilli Organizativ

Shënohet 100 - Vjetori i Kongresit të Dibrës



Në ambientet e komunës së Dibrës së Madhe më 15 maj u konstit uua dhe verifikua Këshilli Organizativ për manifestimin e 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës. Kryetar i këtij këshilli është z. Abdylaqim Ademi, z/vendëskryeministër i Qeverisë së Maqedonisë, z/vendëskryetar është Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës së Madhe, ndërsa anëtarë të këtij komisioni janë Ilir Krosi, kryetar i Bashkisë së Peshkopisë, Prof. Dr. Mahmud Hysa, Prof. Dr. Ramiz Abdyli, drejtor i Institutit Albanologjik në Shkup, Prof. Dr. Nuri Abdiu, kryetar i Shoqatës së Intelektualëve Dibranë në Tiranë, Prof. Dr. Arjan Kadiu, kryetar i Shoqatës "Bashkësia Dibrane" në Tiranë, Dr. Myzafer Bislimi, anëtar i Institutit të Historisë në Shkup, Mr. Ruzhdi Lata, myfti i Dibrës së Madhe, Nizamedin Papraniku, kryetari i KK të Dibrës së Madhe, Altin Spahiu, drejtor i Qendrës për Kulturë-Dibër e Madhe dhe Ibrahim Kolari, kryetar i Shoqatës Atdhetare Dibrane në Njy Jork.

Argëtim Fida, nikoqir i këtij manifestimi, me këtë rast para gazetarëve, deklaroi se:"Në takimin e parë të punës për arsye objektive nuk ishin të pranishëm katër anëtarë, por na autorizuan që në emër të tyre të sjellim këto vendime për ecurinë organizative e programore.

Manifestimi i Kongresit të Dibrës, shtoi Fida, do të mbahet me 23 dhe 24 korrik 2009 në Dibër të Madhe dhe evenimentet kryesore do të mbahen në ambientet e Qendrës për Kulturë. Ditën e parë do të mbahet akademia solemne, ku do të ftohen personalitete eminente të politikës, shkencës dhe kulturës shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare. Përveç kumtesës qëndrore lidhur me 100-Vjetorin e Kongresi të Dibrës, do të ketë edhe fjalime përshëndetëse dhe fjalime mikpritëse nga kryetarët e dy Dibrave, nga z. Abdylaqim Ademi, kryetar i Këshillit organizativ dhe nga të pranishëm të tjerë. Do të ketë një program cilësor artistik dhe kulturor me recital dhe pika të muzikës serioze.

Dita e dytë e këtij manifestimi, theksoi Argëtim Fida, do të jetë ditë e konferencës shkencore, ku me temat e tyre lidhur me Kongresin e Dibrës, do të marrin pjesë historianë dhe shkencëtarë nga të gjitha trojet etnike. Pas miratimi të konkluzave nga kjo konferencë do të përmbyllen edhe punimet e kësaj conference shkencore.

Shpresoj se vendimet që i sollëm sot do të bëjnë jehonë tek të gjithë intelektualët e punëtorët shkencorë të histories, që t'i bashkangjiten dhe përgjigjen thirrjes për të marrë pjesë me temat e tyre në punimet e kësaj konference shkencore, por njëkohësisht edhe mediumet dhe të gjithë intelektualët duhet t'i japin jehonë këtij eveniment gjithëkombëtar. Shpresojmë që Dibra në këto dy ditë të manifestimit, siç ka qenë para 100 vitesh qendër e tërë atdhetarëve nga 5 vilajetet ku u sollën vendime historike për kombin tonë, edhe kësaj here do të dëshmohet në mënyrën më madhështore. Komisioni tregoi një seriozitet dinjitoz në përgatitjen e këtij manifestimi dhe në takimet e ardhshme do të konkterizohen edhe detajet më të vogla. Qytetarët dibranët do të dijnë ta tregojnë bujarinë dhe mikpritjen si para 100 vjetëve, duke dëshmuar se dijnë të organizojnë manifestime të këtilla, tha në fund Argëtim Fida.

REXHEP TORTE

Bëhuni pjesë e gazetës!

E-mail: **rrugaearberit@gmail.com.**

Tel. **069 20 68 603 / 068 31 19 232**

www.**dibra**.org

Ditën e parë do të mbahet akademia solemne, ku do të ftohen personalitete eminente të politikës, shkencës dhe kulturës shqiptare nga të gjitha trojet shqiptare. Përveç kumtesës qëndrore lidhur me 100-Vjetorin e Kongresi të Dibrës, do të ketë edhe fjalime përshëndetëse Do të ketë një program cilësor artistik dhe kulturor me recital dhe pika të muzikës serioze.

Dita e dytë e këtij manifestimi, do të jetë ditë e konferencës shkencore, ku me temat e tyre lidhur me Kongresin e Dibrës, do të marrin pjesë historianë dhe shkencëtarë nga të gjitha trojet etnike.

Kongresi i Dibrës u mbajt nga data 23-29 korrik 1909. E veçanta e këtij kongresi është se ai organizua nga xhonturqit për qëllimet e tyre, për të shprehur afërsinë e shqiptarëve me turqit dhe u kthye në një kongres proshqiptar falë këmbënguljes së shumicës së delegatëve shqiptarë. Fakti që Kongresin e organizuan xhonturqit, debatet e ashpra të zhvilluara gjatë punimeve të tij kanë lënë të hapur shtegun për një interpretim jo të saktë të vendimeve të dala prej tij. Por në fakt **Kongresi i Dibrës ishte kongresi që vuri themelet e zgjimit të ndërgjegjes sonë kombëtare për pavarësi nga Turqia.**

Krerët e Komitetit "Bashkim e Përparim" gabuan rëndë në llogaritë e veta, kur e caktuan Dibrën si qendër të këtij Kongresi. Tubimi i korrikut 1909 dëshmoi se Shehri jo vetëm kishte qenë, por dhe kishte mbetur një nga vatrat më të rëndësishme të lëvizjes kombëtare shqiptare. Turqit harruan se pikërisht në Dibër në korrik 1844 me ekspeditën e Hajredin Pashës lanë jo pak, por 12 mijë forca në fushën e luftimit, se më 1 nëntor të vitit 1878, pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u mblodh Kuvendi i Dibrës për të gjetur terrenin e zbatimit të vendimeve të kësaj lidhjeje që jo rastësisht kishte kryetar një dibran të madh, patriotin Iljas Pashë Dibra (Qoku). Edhe në vitin 1880 kemi përsëri një kuvend mbarëkombëtar në Dibër të Madhe. Në mars të vitit 1899, pas kuvendit të Pejës në janar të vitit 1899, mblidhet Kuvendi i Dibrës. Po kështu në tetor të vitit 1908 në Dibër u themelua klubi patriotik "Bashkimi" me një numër të madh patriotësh nga të gjitha krahinat e Dibrës dhe më gjërë. Pra ky ishte terreni patriotik që kishte në fakt Dibra, por që disa nëpunës dhe pashallarë të shitur përpiqeshin tja sërvirnin Dibrën, portës së lartë të Stambollit, si proturke.

Në kongres morën pjesë delegatë nga të katër vilajetet shqiptare, Janinës, Manastirit, Kosovës dhe Shkodrës. Kishte edhe delegatë nga vilajeti i Selanikut. Parë në këtë plan ky kongres ishte jo vetëm mbarëshqiptar por edhe ballkanik sepse morën pjesë përveç shqiptarëve përfaqësues nga Stambolli, serbë, maqedonas, grekë, bullgarë, arumunë (vllehë) etj. Kryetar i Kuvendit ka qenë Vehbi Dibra, i cili me 28 nëntor 1912 do të ishte kryetar i Pleqësisë (parlamentit). Pritja nga qytetarët e Dibrës ka qenë madhështore.

Kongresi në sajë të luftës së delegatëve atdhetarë u shpall dhe vijoi punimet si kongres thjesht shqiptar. Në kongres, krahas turqishtes si gjuhë zyrtare e Parandorisë, u përdor dhe gjuha shqipe, çka u pasqyrua dhe në dokumentet përfundimtare të tij, të cilat u botuan në të dy gjuhët. Kongresi i Dibrës ka meritën e madhe se ai dëshmoi katërcipërisht, që elementi shqiptar ishte nga ana demografike dhe etnike elementi mbizotërues në zotërimet osmane në Ballkan aso kohe. Kjo, jo vetëm përsa i takonte katër vilajeteve perëndimore të Rumelisë, që bënin pjesë në konceptin territorial të kërkesave kombëtare të shqiptarëve, që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Platforma e Kongresit e parapërgatitur qysh më parë nga organizatorët xhonturq, u hodh poshtë nga shumica e delegatëve që në mbledhjen e parë të tij. Si rrjedhim, Kongresi i Dibrës, sapo filloi punimet e tij, pushoi së qeni një forum xhonturk dhe u shndërrua menjëherë në arenë të ndeshjes së qarqeve atdhetare të shqiptarëve me organizatorët e tij. Për më tepër ky Kongres, në saje të guximit dhe vendosmërisë së delegatëve atdhetarë, u kthye në tribunë të zjarrtë të parashtrimit me forcë të problemeve kardinale që shqetësonin Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Patriotët shqiptarë nuk u mjaftuan me kaq, por mundën, gjithashtu, që në këtë tubim të sanksiononin, qoftë dhe në formë të moderuar, kërkesa që objektivisht çonin në drejtim të hapjes së rrugës për realizimin e autonomisë së Shqipërisë.

Kongresi u shndërrua në një forum vendimmarrës i shqiptarëve përballë pushtetit xhonturk dhe në praninë sa autoritare po aq dhe aktive të përfaqësuesve të tij. Me këmbënguljen e delegatëve atdhetarë tubimi i vijoi punimet dhe mori vendime shumë të rëndësishme për të ardhmen e Shqipërisë.

Prof Zekeria Cana në librin e tij "Lëvizja kombëtare shqiptare në Kosovë 1908-1912" faqe 61 thekson se me kërkesën e përfaqësuesve shqiptarë patriotë u hoqën nga programi disa formulime dhe u aprovua versioni i ndryshuar që përmbante një varg kërkesash ekonomike dhe kombëtare si:1) ndërtimi i hekurudhave dhe tharja e kënetave moçalike 2) mësimi i njohurive moderne, 3) Hapja e shkollave fillore dhe të mesme me mësim në gjuhën shqipe, 4) ndarja e shkollës nga kisha dhe xhamia, zhvillimi i ceremonive fetare në gjuhën amtare, 5) njohja e zakoneve dhe e gjuhës shqipe nga ana e pushtetit shtetëror , 6) vendosja e regullit në sistemin e rekrutimit në ushtri.

Kërkesa të tilla si ajo që nëpunësit të dinin gjuhën dhe zakonet e vendit, futja e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore, hapja e shkollave në gjuhën shqipe, kryerja e shërbimit ushtarak në vend nuk përbënin një fitore të vogël për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Kongresi atyre iu dha një forcë vendimore me peshë shumë të madhe, sepse në të përfaqësoheshin të gjitha krahinat e vendit dhe të gjitha forcat politike shqiptare të të gjitha krahëve. Që nga Lidhja e Prizrenit, asnjë tubim masiv i tillë i shqiptarëve në vend nuk kishte arritur t'i parashtronte kërkesa të tilla me karakter të theksuar politik autoriteteve osmane.

Atdhetarët e shquar, pjesëmarrës të këtij kongresi shfrytëzuan rastin me shumë aftësi dhe guxim për të realizuar në këtë kongres ato çka rrethet politike atdhetare shqiptare prej kohësh po përpiqeshin për t'i formuluar dhe paraqitur në mënyrë programatike në emër të popullit shqiptar. Në këtë kuptim, Kongresi i Dibrës ishte një hap i ri shumë i madh përpara në parashtrimin dhe në rrugën e realizimit të të drejtave kombëtare të shqiptarëve.

Shqiptarët në këtë kongres nuk kanë shërbyer si mashë në duart e xhonturqve. Jo rastësisht, Dibra, pas një viti, u bë një nga objektivat e terrorit të egër të gjeneralit famëkeq Shefqet Turgut Pashës. Në fund të fundit, ekspedita ushtarake e tij kishte për synim të pengonte fillimin e vënies në jetë të vendimeve të Kongresit të Dibrës. Atdhetarët dibranë me Vehbi Agollin (Dibrën) në krye dhanë ndihmesën e vet në kthesën që morën punimet e Kongresit si dhe për vendimet e rëndësishme që u morën aty. « E gjithë Shqipëria nderon dhe përulet me respekt përpara atdhetarëve si Hafiz Ali Korça, Abdyl Ypi, Qenan Manastiri, të cilët qëndruan në ballë të debateve të ashpra që u zhvilluan në Kongres. Duke pasur përkrah dhe Rexhep Vokën e Haxhi Ali Elbasanin e të tjerë, me luftën e tyre të vendosur, e bënë Kongresin e Dibrës arenë të luftës së mendimit më të përparuar atdhetar të shqiptarëve për atë kohë, kundër qëndrimeve reaksionare dhe antishqiptare të xhonturqve dhe të elementëve turkomanë. Këta atdhetarë të mbështetur nga Dervish Hima, Ibrahim Temo, Sotir Peci, Ferit Ypi, Fehim Zavalani e plot të tjerë që nuk morën pjesë drejtpërsëdrejti në mbledhjet e komisionit të ngushtë të Kongresit, bënë që kongresi të shndërrohej në tribunë luftarake për shpalosjen e kërkesave të mirëfillta politike të shqiptarëve, të kërkesave më të përparuara të rretheve atdhetare shqiptare. Me këtë rast nderohet një plejadë atdhetarësh të shquar shqiptarë, pra, jo vetëm dibranë, të fillimit të këtij shekulli. Të gjithë së bashku këta atdhetarë e shndërruan Kongresin e Dibrës në një forum të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare në të cilin u mbajtën qëndrimet dhe u morën vendimet më të avancuara dhe më me peshë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, për periudhën pas Lidhjes së Prizrenit" shkruan në kumtesën e tij kushtuar 95 vjetorit të këtij kongresi Prof Gazmend Shpuza.

Analiza e vendimit të Kongresit të Dibrës për çështjen e alfabetit dëshmon katërcipërisht se nuk kemi

Kongresi që vuri themelet e zgjimit të ndërgjegjes kombëtare për pavarësi

të bëjmë me një kundërvënie ndaj vendimit të Kongresit të Manastirit, por një mbështetje e tij. Një vend të rëndësishëm në punimet e Kongresit të Dibrës zuri diskutimi i propozimit të klerikut atdhetar Hafiz Ali Korça për hapjen e shkollave shqipe e mbajtjen e tyre nga qeveria si dhe për futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore. Ai parashtroi me vendosmëri:

"Ndër ato fshatra ku s'ndodhen shkolla fillore medoemos të çelen edhe ndër gjithë shkollat e Shqipërisë gjuha **kombëtare** të këndohet... Megjithatë, në Shqipëri kur tërë gjuhët mësohen gjuha e jonë përse të mos mësohet?". Mendimet e Hafiz Aliut u mbështetën dhe nga Abdyl Ypi, i cili foli në gjuhën shqipe. Fjala e tij u prit me duartrokitje dhe me miratimin e shumë vetave, sidomos nga delegatët Seidi, Murad Jakova, si dhe nga Jusuf bej Karahasani. Ky deklaroi me vendosmëri: "Nuk heqim dorë nga gjuha jonë". Ishte vendosmëria e këtyre atdhetarëve që i detyroi dhe elementët e lëkundur, por dhe ata kundërshtarë të pranonin që në vendimet e Kongresit të futej dhe kërkesa për gjuhën dhe shkollat shqipe, pavarësisht nga kundërshtitë lidhur me çështjen e alfabetit. Halim Tetova, nga fundi i debatit nxorri në shesh përsëri çështjen e shkronjave, pra të alfabetit, diskutim i të cilit në këtë mbledhje u mënjanua me këmbëngulje nga delegatët që kishin parashtruar kërkesën për shkollat shqipe.

Vendimet e Kongresit nuk u botuan me alfabetin turko-arab, por me alfabetin latin të miratuar në Manastir dhe në gjuhën zyrtare të Perandorisë, në osmanisht. Edhe Rexhep Tetova i cili nuk u tregua këmbëngulës në zbatimin e vendimeve për të



cilat ishte shprehur dhe vetë në Dibër, kujtimet e tij për Kongresin e Dibrës i botoi në shqip me alfabet latin.

Vendimi i Kongresit të Dibrës për çështjen e alfabetit që "**menyr' e mësimit është pas dashjes të cilit do dhe e lire"** ishte formuluar dhe parashtruar, në fakt, në përputhje me vendimet e Kongresit të Manastirit. Si i tillë, ai qe pasqyrim i shkallës së zhvillimit të lëvizjes kulturore dhe arsimore kombëtare Shqiptare.

Shtypi i kohës dhe gazeta të ndryshme e vunë Kongresin e Dibrës për nga rëndësia, jo pa të drejtë, në një rrafsh me Kongresin e Manastirit, duke shprehur dhe pakënaqësinë ndaj vendimeve jo plotësisht të dëshiruara të të dy këtyre kongreseve. Lënia e lirë e zgjedhjes së alfabetit, sipas dëshirës, në Kongresin e Dibrës ishte, në fakt, i njëjtë për nga formulimi dhe vlera me vendimin e dyzuar të Kongresit të Manastirit. Vendimi i Kongresit të Manastirit kishte parasysh ata që dinin të lexonin shqip me alfabet latin, numri i të cilëve edhe pse shtohej pa pushim, relativisht ishte tepër i kufizuar. Ndërsa, vendimi i Kongresit të Dibrës kërkonte të neutralizonte ata që kishin mësuar apo mësonin në shkollat turke, numri i të cilëve ishte shumë i vogël në krahasim me numrin mbizotërues të analfabetëve, por gjithsesi më i madh se ai i atyre që atëherë quheshin latinxhinj.

Mos të harrojmë që Kongresi i Dibrës u bë pas terrorit që ushtroi ekspedita ndëshkuese e Xhavit Pashës në pranverë të vitit 1909 dhe në prag të rifillimit të saj në vjeshtën e po atij viti. Në kundërshtim me synimet e nismëtarëve xhonturq, Kongresi i Dibrës vijoi dhe përfundoi si një kongres thjesht shqiptar. Në të, siç do të shkruante dhe gazeta "Shqypeja e Shqypënisë", peshorja "randoi më shumë në anët e shqyptarëvet". Si gjuhë e kongresit, u përdor dhe shqipja, çka u pasqyrua dhe në dokumentet përfundimtare të tij, të cilët u botuan jo vetëm në gjuhën zyrtare të Perandorisë, por dhe në gjuhën shqipe me alfabetin latin. Është meritë e delegatëve atdhetarë të Kongresit të Dibrës, të cilët duke u përballur me trysninë e xhonturqve dhe sabotimet e elementëve jo të paktë turkomanë, ngritën me forcë dhe mundën ta fusnin në vendimet e tij dhe kërkesën për hapjen e shkollave të reja shqipe të mbajtura nga shteti dhe futjen e gjuhës shqipe ndër shkollat shtetërore ekzistuese. Me këtë kërkesë ata iu kundërvunë autoriteteve xhonturke që po shpërfillnin si kushtetutën ashtu dhe aktet dikasteriale që kishin nxjerrë vetë me lejen për futjen e mësimit të gjuhës shqipe në shkollat shtetërore turke.

Kërkesa për hapjen e shkollave shqipe dhe futjen e gjuhës shqipe në shkollat shtetërore dhe përfshirja e saj në vendimet e Kongresit të Dibrës, e theksojmë, në përfundim të ballafaqimeve të ashpra me përfaqësuesit e autoriteteve xhonturke dhe me elementët turkomanë vendas, shënon një sukses shumë të rëndësishëm për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare. Ajo u arrit dhe u sanksionua në një tubim me karakter të gjerë politik të përmasave që nuk mund të krahasohet për nga pesha dhe rëndësia me tubimet e tjera të organizuara para dhe madje dhe pas tij.

Kërkesa e Kongresit të Dibrës drejtuar qeverisë për çështjen e hapjes së shkollave dhe mësimin e gjuhës shqipe ishte në fakt platformë pune. Pa u shqetësuar nga formulimi pragmatist, gjithsesi realist që iu bë në vendimet e Dibrës kërkesës për çështjen e alfabetit, Kongresi i Elbasanit u muar me masat organizative për vënien në jetë të vendimeve të mëparshme jo vetëm të Kongresit të Manastirit, por dhe atij të Dibrës. Aty u shqyrtua, siç dihet, çështja e çeljes së një shkolle normale, krijimi i një qendre të vetme për drejtimin dhe organizimin e lëvizjes arsimore në vend. Këto vendime nuk anashkalonin vendimet e Kongresit të Dibrës për çështjen e shkollës, përkundrazi merrnin masa për sendërtimn e tyre në praktikën shkollore. Zhvillimet e mëvonshme e përligjën plotësisht qëndrimin realist dhe të drejtë të mbajtur në Kongresin e Dibrës për sa i takonte alfabetit. Kongresi i Manastirit, Kongresi i Dibrës, Kongresi i Elbasanit dhe Kongresi i Dytë i Manastirit ishin hallka të rendësishme organizative të një procesi të pashmangshëm për trajtimin politik kombëtar të arsimit shqip dhe të çështjes së alfabetit. Ato qenë, në mungesë të një qendre të vetme organizative dhe udhëheqëse të Lëvizjes Kombëtare, përpjekje për organizimin e forcave atdhetare dhe bashkërendimin e veprimtarisë së tyre në shkallë mbarëshqiptare. Çështja e mësimit të gjuhës shqipe madje dhe e alfabetit të saj, mbeti deri në fund të sundimit osman një çështje thellësisht politike. Por fati i arsimit kombëtar shqiptar dhe i çështjeve të tjera kombëtare do të zgjidhej në fushën e betejave gjatë kryengritjeve të viteve 1911-1912, lëvizje që u finalizuan me shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912. Kur flasim për Kongresin e Dibrës nuk mund të mos sjellim ndërmend dhe të vëmë në pah mesazhet që na vijnë pas 100 vjetësh nga punimet e tij, mesazhet e paqes, bashkëpunimit, tolerancës dhe për përpjekjet për një Europë të bashkuar dhe pa konflikte etnike.

Përgatiti: SAKIP CAMI

Shkruar nga Abdyl Ypi në vitin 1918

Kongresi i Dibrës dhe Hafiz Ali Korça

Kjo Kongresë, neve na ka lënë një kujtim të shenjtë e të paharrueshëm. Ndjenjat e shenjta dhe shijat e shtrenjta sa për vehtën t'ime le qi do të mos i harroj kurrë, por më vjen se kur sjellë ndërmend më mbushet kraharori plot gaz, e më duket se mos gjindem akoma brenda n'atë mbledhje të shenjtë qi bisedohesh për gjuhën e ambël kombëtare, bisedohesh për lidhjen vllazërore të gjithë Shqipërisë. Atje u mblodhën delegatët e pesë vilajeteve, atje treqind e pesëdhjetë veta që përfaqesonin popullin e të pesë vilajeteve ishin nga ma të ndjerët e ma të vlefçmit e zotërinjëve. Brenda në kta zotrinj me gjithë qi nji shumicë ndodhëshin nga anëtarët e Xhemijetit dhe armikët e kombësisë porse ndër ata kishte edhe burra qi luftonin sheshazit e trimnishit për mbrojtjen e gjuhës e për lirinë e kombit të vet. Ja Z Hafiz Ali ishte nga ata burrat që luftonte me rreptësi për gjuhën, dhe për lirin e kombit që na ktu me radhë si shërbimet e tija ashtu dhe do të tjervet do t'i kallzojmë. Bujarët dibranë na pritën me nderime aqë të zemërta sa shpirti i jonë kurrë si harron.

Mbledhja e përgjithshme
E shtunë 24 korrik 1909

Mëngjes ishte, kur u mblodhëm në kllupin e ushtrisë. Gjithë delegatët kur ishin në sallon kopja e programit q'ishte gaditur prej Xhemijetit, u nda nëpër duart e delegatëve. Ky program përmbante katër pika politike.

Muftiu Dibrës Z. Vehbi me një diskur të bukur që dha e çfaqi randësinë të programit mjaft. Ky shkrimtari i ksaj libres u ngrit më kambë dhe tha: " para se hyjmë në bisedimet e nevojshme duhet ta shqiprojmë nji herë landën e programit pastaj të flasim përmbi detyrat e delegatëve, që ta dimë a kemi të drejtë që të çpallim dhe na nevojat tona a jo? A po na duhet vetëm të vërtetojmë kto pika dhe të ndahemi? Shumica duhet të bisedojmë.

Z. Mustafa Muderrisi i Ohrisë dhe disa të tjerë:" Ska nëvojë për bisedime por t'i vërtetojmë kto katër pika dhe të përndahemi.

Z. Hafiz Korça: "Kurse s'paska nevojë për bisedim përmbi çështjet e nevojshme të popullit atëherë qenkemi mbledhun kot; kurse qëllimi paska qenë vetëm për të vërtetuar këto katër nyje. i vërtetonim që kur ishin nëpër kllubet dhe nuk kishin ardhur këtu. Ksi soj u banë mjaft fjalë, si taraksi pak nxehtësi e fjalëve, shumica dulli jashtë, dhe për të biseduar çështjen me gjak të ftohtë u mblodhën në Dergjah të Baba Shabanit. Atje u këmbyen shumë fjalë, kush t'ikim e kush të rrimë, fundi u tha që ma mirë që qëndrojmë porse të gjithë s'është e mundur së bashku të bisesojmë" në kuvend ma tepër se dyzet e pesë veta të mos ketë. Së fundi prej ç'do vilajeti me vota u zgjodhën nga disa dhe ksi soj u përba një komision prej dyzet e pesësh dhe këta zotërinj formuan Kongresësn.

Mbledhja e parë e Kongresit

Të dymbëdhjetën të Korrikut ditën e hanë Kongresa u mblodh në shtëpit të Z. Zejnu-llah. Për kryetar të parë u zgjodh Z. Vehbi Dibra, për kryetar të dytë Z. Mufti Kara Rexhepi edhe për sekretar Z. Ihsan Bej Selaniku. Shkrimtari i kësaj libërës u këndua teksi i programit tha: "Emrin e këti teksi mundet ta cakëtojë vetë kongresi. Mbi këtë fjalë emri i u fshi. Veç kësaj mbi kritikat e mija i u ndërtuan edhe disa fraza prej nyjes së tretë, e cila thoshte, kur se Shqiperi e sipërme sjellë do nji trazim ta bindnjë Shqipëri e poshtme e përkundrazi e sipërmja të bindje të poshtmen, veç kësaj në punoftë do nji gabim Elbasani ta bindnjë Korça etj(?) Por dhe kto u ndryshuan. Z. Suhejl (Ishtip) kundërshtoj tepër por si pati duk se nyja, me shumicë votash u mirësua . . . Kur u këndua e katërta, ky shkrimtari vuri këmbë që kjo të ngrihet krejtë. Z. Suhejl edhe Z Halim Bej Tetova vunë këmbë të lihej si ç'ishte.

Ky shkrimtari: "Nji detyrë q'i përket drejt për së drejti ushtris atëherë me ç'të drejtë do ta shtrëngojnë popullin të përlaj pushkën dhe ta bëjë detyrën e ushtrisë?

Z. Sudi: " Përkrah Zotin Suhejl"

Z. Qenan Manastri: "Nuk donja të besoj se Z Suhejl do ta thoshte ket fjalë se le të jashtmit që do të tallen me ne, por edhe së brëndëshmi do të bëje një përshtypje të keqe... kjo është detyrë e qeverisë"

Z. Sudi: "Por atje ku nuk ndodhen ushtarë, populli a të mbyten njeri me tjetrin"?

Z, Qenan: "Më falni të sos fjalën, kësaj i përgjigjet qeverija"

Z Halim: "Kurse qeverija e merr vetë dashësin atëherë përse të mos i ndihmojë? Jam antar të lihet si asht" Përmi këtë çështje, fjala u zgjat mjaft dhe së fundi me vota shumicej kjo nyje u lehtua.

Mbledhja e dyt e Kongresit


Atë ditë pas dreke ora 8, 30 përsëri Kongresa u mblodh.

Mufti Z. Kara Rexhep: "Jam i mendjes të merren ushtarë dhe prej atyre viseve qi gjër më sot s'kanë dhënë"


Z Riza Bej Shkodra: " Vec Shkodrës, na kena me ngel si motit". Fjala e tij u përkrah dhe çështja u la. Sado që u la, Z Aqif Pasha Elbasani dhe Sadik Pasha Janina: "Fjalët e Z Rexhep janë të arsyeshme lutemi të shënohen. U dha vendim që Z Ihsan ti shënoje .

(Vijon në faqen 13)

Fotot: Bujar Karoshi









Kuvendi i Dibrës në Pallatin e Kongreseve

(Vijon nga faqja 3)

Pas përfundimit të këngës, që domosdo publiku u ngrit në këmbë, një tufë me lule të freskëta për Qerimin e ky një disk dhuratë për prezantuesin Defrim Methasani. Ishte disku i parë i Qerimit ku në të gjitha këngët spikaste emri i poetit Naim Plaku. Ishte ky si i vetmi autor pothuaj në të gjitha këngët e këtij disku. E ne nuk na mbetej vetëm të uronim Qerimin që ky disk të mos mbetet i fundit.

Ndoshta sonte në këtë sallë të Pallatit të Kongreseve artëdashësit dibranë njohën nga afër dhe se është vetë dibrane këngëtaren e njohur Çiljeta Xhilaga, e cila pas një serenate korçare këndoi edhe një potpuri popullore të Shqipërisë së veriut. Më pas Vera Laçi me zërin e saj të ëmbël ngriti në këmbë edhe njëherë sallën e mbushur plot për plot. Me këngën"M'ka marrë malli për Dibrën time" këngëtari dibran Kujtim Shehu zgjoi ndjenja malli për vendlindjen. Gjatë kësaj kënge ndonjë lot ua tradhtoi sytë njerëzve e u rrëshqiti në faqe. Liri Rasha kishte bërë surprizën më të madhe për të pranishmit. Doli në skenë, doli me kostum kombëtar dhe zëri i saj u bë njësh me sallën. Me kostum kombëtar doli dhe këndoi edhe Sherif Dervishi. Çifti simpatik i humorit, njëri nga Dibra e tjetra labe, Behar Mera e Rita Lati bënë që me humorin e tyre të qeshnin të gjithë.

"Na zgjatët jetën, na shpëtuat nga stresi për pak kohë, ju lumtë", shpreheshin njerëz të ndryshëm nga salla. Kjo natë e gjatë nuk kishte të mbaruar, nuk kishin të mbaruar as surprizat për të pranishmit. Surprizë ishte artistja Manjola Nallbani në duet me tenorin Kastriot Tusha. "Kjo sallë është e mrekullueshme me pjesëmarrjen tuaj", tha këngëtarja Manjola Nallbani para se të këndonte më tenorin Tusha këngën "Bashkoi molla zemrat tona", që publiku i gjerë e din për këngë shkodrane, ngaqë kompozitori është shkodran, por frymëzimin e ka marrë nga Peshkopia, ngaqë në kohën kur e ka kompozuar atë ai punonte në Pallatin e Kulturës së Dibrës.



Foto: B.Karoshi

Sokol Olldashi: "Ndjehem shumë i emocionuar për këtë festë. Kemi bërë rrugë në të katër anët e Shqipërisë, rrugë edhe më të mëdha se kjo, më të gjata, më të gjera, kudo na kanë pritur mirë, por jo si këtu. Është një eveniment i veçantë që na emocion dhe do ju shprehja mirënjohjen e thellë për këtë veprimtari. Është vërtet një kënaqësi e pamatë".

Surprizë fantastike ishte dhe Cirku i Peshkopisë, që nën drejtimin e Agron Strazimirit, mrekulloi sallën për shumë minuta.

"Kjo mbrëmje nuk ka heronj, as kompani që e mbështesin, apo të tregojmë me dorë protagonistë, por të jemi të sinqertë, nisma dhe ideja e parë ka emrin e një djali të suksesshëm Dibran në Tiranë, Rakip Suli, i cili me dëshirën e tij të mirë dhe shpirtin e tij fisnik, vendosi ta kthejë sonte këtë sallë në një odë të madhe Dibre, duke u bërë kështu "de fakto" një ambasador i lidhjes mes njerëzve dhe promovimit të vlerave më të mira të komunitetit dibran. Kjo veprimtari ka edhe mbështetjen e miqve të tij, Musa Ricku, Zabit Muda, Përparim Golli, Xhetan Ndregjoni dhe Bilbil Lleshi". Pas këtyre fjalëve, ngjitet në skenën e Pallatit të Kongreseve, Rakip Suli.

"Para se të ngjisja këto shkallë pata emocione. Por, nga ana tjetër ndjehesha shumë i lumtur që mblidheshin dibranët në Pallatin e Kongreseve për të festuar fillimin e Rrugës së Arbërit, e cila ju ka munguar me vite Dibranëve, tha ai. - Por më në fund qeveria Berisha po e bën realitet këtë ëndërr të Dibranëve. Kjo rrugë nuk do sjellë vetëm bashkimin e Dibrës me Tiranën, jo vetëm zhvillimin ekonomik, zhvillimin e turizmit, zhvillimin kulturor, por edhe një lidhje me Maqedoninë dhe Kosovën. Ju falënderoj të gjithëve që sonte së bashku bëjmë këtë festë të madhe që na afron, por edhe që na bashkon. Le të gëzojmë tok së bashku, le të dëgjojmë së bashku muzikën dhe këngët dibrane".



Foto: B.Karoshi

Komentatori i njohur, Ismet Bellova, Mësues i Popullit, falënderoi sponsorët e kësaj veprimtarie dhe organizatorët. "Janë gjashtë Dibra, tha Bellova. Dy janë atje ku kanë qenë tërë jetën rrëzë Korabit gjigant e madhështor, është një Dibër në mes Tiranës që ka rreth 100 mijë banorë, ku jam lindur dhe jam rritur dhe që është quajtur "Mahalla e Dibranëve". Është edhe një Dibër në Paskuqan e Kamëz, një Dibër në Durrës dhe një tjetër në New York. Kjo mbrëmje të shërbejë si fillesë dhe për një ritëm të shpejtë të punimeve në Rrugën e Arbërit", mbylli përshëndetjen Bellova.

Në përshëndetje e tij, Ministri i Transportit dhe punëve publike tha:

"Ndjehem shumë i emocionuar për këtë festë. Kemi bërë rrugë në të katër anët e Shqipërisë, rrugë edhe më të mëdha se kjo, më të gjata, më të gjera, kudo na kanë pritur mirë, por jo si këtu. Është një eveniment i veçantë që na emocion dhe do ju shprehja mirënjohjen e thellë për këtë veprimtari. Është vërtet një kënaqësi e pamatë.

Brenda këtij viti do tenderohen tre lote të tjera nga Bulqiza deri të Ura e Vashës dhe një lot nga Tirana drejt urës së Brarit. Do të mbetet një lot i fundit nga Ura e Brarit te Ura e Vashës ku përfshihet edhe një urë që është vepër arti, një urë që është shumë komplekse dhe që do marrë pak më shumë kohë. Sot nuk besoj të flitet më nëse është Rruga e Arbërit apo nuk është rruga e Arbërit. Rruga e Arbërit avancon çdo ditë, është tashmë një realitet dhe unë kam pasur fatin të jem ministër i Punëve Publike, kur kryeministri i këtij vendi ka marrë vendimin politik për ta ndërtuar këtë rrugë, pavarësisht kostos financiare. Nuk është e vetmja që po bëjmë në trevën e Dibrës. Jemi duke punuar në rrugën Peshkopi - Kolosjan - Kukës, jemi duke punuar për riveshjen e rrugës Peshkopi - Ura e Çerenecit dhe pastaj nga Çereneci drejt Steblevës dhe Librazhdit. Do fillojë shumë shpejt edhe rruga nga Ura e Matit - Fushë Muhurr dhe pas kësaj Dibra bëhet një trevë që do kapet me rrugë nga gjitha drejtimet.

Ndërsa deputeti Albert Farruku, gjithashtu një nga organizatorët tha: "Te foto është Ura ku ka kaluar Skënderbeu me 300 dibranë, por ne do i shkojmë pas Skenderbeut edhe me rrugën e re".

kryesore



Foto: B.Karoshi

Bujar Kapexhiu: "Ky takim do mbetet i paharruar në historinë e ndërtimit të kësaj rruge të madhe, e cila do të sjellë integrimin e Dibrës dhe rajonit drejt proceseve integruese evropiane. Të gjithë së bashku jemi një impuls gjingand drejt realizimit të kësaj ëndrre. Rruga e Arbërit ka sot të shtruar në tabanin e saj mendjen dhe shpirtin e çdo dibrani, duke u bërë kështu traseja më e shkurtër, më e gjerë, më e fortë, më e bukur e përshëndetjes sonë, e përqafimit, e projekteve, e bashkëpunimit dhe realizimit të ëndrrave të çdo dibrani.

Në këtë mbrëmje festive përshëndeti edhe Prefekti i Dibrës, Xhafer Seiti. "Falënderoj organizatorët e këtij aktiviteti aktiviteti kaq madhështor, tha ai. Dibranët bëjnë gjëra të mrekullueshme, siç po bëjnë edhe këtë aktivitet".

Seiti falënderoi ministrin e Transporteve për kontributin në nisjen e punimeve për Rrugën e Arbërit, gjithashtu edhe deputetët e Dibrës dhe Matit për kontributin e tyre në këtë proces, si dhe median e Dibrës, e cila ka dhënë një kontribut të veçantë në promovimin rrugës. Dibra po lidhet me Kukësin, Librazhdin dhe Matin, duke ndaluar kështu braktisjen e saj."

Musa Rriçku, njëri ndër biznesmenët që ka kontribuar për këtë aktivitet tha: "Jemi mbledhur të gëzojmë të gjithë së bashku. Kjo është një natë festive dhe argëtuese. Këtu po shpaloset kënga dhe folklori i pasur i Dibrës".

Spektaklit i erdhi fundi. Dy prezantuesit simpatik Defrim Methasani e Ejona Torba ftojnë të gjithë artistët në skenë. Të gjithë bashkë filluan të këndojnë një potpuri dibrane . Perdja e skenës ra e njerëzit filluan të dalin jashtë. Sa e shkurtër ishte kjo natë dibrane. Te porta kryesore e Pallatit të Kongreseve u takuan edhe njëherë me njëritjetrin, u ndanë duke u përqafuar e duke këmbyer numrat e telefonave. "U lumtë, na bashkuan sonte të gjithë bashkë. Ndoshta përsëri kështu do të bashkohemi, vetëm për gëzime".

Dibrës kurrë nuk i kanë munguar djem të tillë me zemër bujare si Rakip Suli, Musa Rriçku, Përparim Golli, Xhetan Ndregjoni e Bilbil Lleshi. Në telefonat e tyre vazhdojnë edhe sot të vijnë mesazhe, edhe nga emigrantët jashtë.

Jehona e Natës Dibrane ne Tiranë vazhdon…

Sot është një natë, por me Rrugën e Arbërit këto netë do të jenë pafund…

Mbresa

Në gjurmë...

Nga: **ZAIM SELMAN ELEZI**

Të kujtojmë dinjitetin e marifetin e çmuar të dibranëve në organizimin e odës së famshme, të konakut të tyre fantastik. Të sjellim në vëmendje për fare pak kohë solemnitetin e fjalës së mençur të tyre, aromën tejet të hollë e aristokratike të ndërtimit të bisedës, po në odat e tyre, të ngrohta e bujare, elegancën e kuvendimin me disa plane e nëntekste që ato dijnë ti bëjnë "si ato" po në këto oda gjithë nur e hijeshi. T`i referohemi kësaj ode, që as më shumë e as më pak, është një skenë e mirfilltë teatri, një akt i një shfaqje, i përcjellë me një regji të vërtetë, por pa regjisor, luajtur me mjeshtri tejet kualitative e profesionale, gjithmonë jo nga aktor por, nga njerëz që në shumë raste, për të mos thënë në të gjitha rastet janë të sapoardhur nga punët rutinë të ditës. Kjo odë, në të vërtetë, gjithmonë me të njëjtën skenografi shilte e lëkura deleje, e me një mutaf në mes të saj, por përherë ndanë oxhakut e sigurisht në të gjitha rastet odat nuk ngjajnë fare me ato të jugut sepse kanë dimensione shumë herë më të mëdha, gati gati skenike, janë arena e bisedave tmerrësisht të kalkuluara e mondane, me fjalë të kursyera e gjithë nënkuptime, ku nevojitet një mendje absolutisht e hollë për ta deshifruar dhe kuptuar, për t`a zbërthyer po me të njëjtën hijeshi e nur që e bën edhe partneri, që e lyp edhe standardi i lartë i këtyre odave, që të ardhura brez pas brezi, përnjëmend gati gati kisha besuar se ishin në zhdukje e sipër, kishin ngelur vetëm në kujtesën e dëshirën time të flaktë që të mos zhdukeshin kurrë, e kurrë të mos shteronin.

Lavdi Zotit jo, nuk kishte ndodhur, dhe unë u bëra pjesë e një ode të tillë, e një ode të njëmendët dibrane, për të më ngrohur zemrën mua e pafundësisht të tjerëve si unë, që u ndodhën në atë odë. Kishte një ndryshim në të vërtetë oda e asaj nate fantastike Maji, me të tjerat, ishte me ndjesi të pazakonta e mbartte në të vërtetë një risk, për të mos kapur dimensionet e parashikuara, për të mos përcjellur dot mesazhet e nevojshme për të cilat ishin grishur të ftuarit. Më të madh e bënte ndryshimin numri i jashtëzakonshëm që merrte pjesë në atë odë, afro 2300 vetë, eh një numër që për hir të së vërtetës kishte lëkundur ndjeshëm besimin e të zotëve të shtëpisë, e kishte tronditur, po realisht i kishte mbushur me ankth. E të drejtë kishin, nuk ishte thjeshtë një odë por Parlament i vërtetë, Parlamenti i Dibrës, me Himn e me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për të qenë i tillë.

Një nevojë e madhe i kishte mbledhur gjithë ato njerëz, një domosdoshmëri i kishte nxitur nismëtarët të grishnin gjithë atë mal njerëzish atë mbrëmje. Dukej që në pamje të parë se gjithçka ishte mbështetur në elegancën e të bërit kuvend në Dibër, ishte parashikuar t'i bihej pragut, të dëgjonte dera, ishte menduar të shkohej në fund vetëm nëpërmjet kodit të kuvendimit dibran. Por do funksiononte vallë?

Në sallën aktualisht më të madhe shqiptare të shfaqjeve e kuvendeve, në Pallatin e Kongreseve, të menduar me zgjuarsi e mençuri të hollë e brilante në të gjitha detajet, ishte thirrur oda e Dibrës ku do të përcillej thirrja e mbështetjes së vazhdimit të rrugës së Arbërit. Vetëm një "mendje dibre" arrin që të kapë mesazhin që do duhej të përcillte kjo mbrëmje. E dëshironin të gjithë sigurisht që kjo të ndodhte, patjetër që prisnim të ndodhte.

E kur kjo ndodhi një lehtësim përfshiu të gjithë sallën, të gjithë miqtë në odën e madhe të Dibrës. Nuk kishe kë të përmendje më parë, kë të lëvdoje më shumë, të gjithë u bënë një, në mënyrë fantastike që të gjithë pa përjashtim, me të ftuar e organizatorë, natyrshëm u shkrinë në një dhe përcollën mesazhin e madh se duhej bërë kjo rrugë, duhej kryer. Ej çfar mrekullie, kur ministri Olldashi me mikrofon në dorë përcolli jo dëshirën e Qeverisë por planet reale të saj që do fillonin në vazhdim e pa ndërprerje për realizimin e kësaj kryevepre për dibranët e më tej, për shqiptarët e nëpërkëmbur në Maqedoni e deri në Kosovë.

E ajo që më shumë më emocionoi mua e të gjithëve, ajo që la mbresë, ishte eleganca me të cilën u përcoll ky mesazh nga dibranët, kultura që ato manifestuan, rruga e zgjuar që kishin zgjedhur për t'a realizuar atë.

Nuk bërtitën në Parlament, nuk u shqyen nëpër mitingje e sajesa zhurmëmëdha, me të cilat na është enjtur koka aq shumë në këto vite të pluralizmit, por me anë të një koncerti e intervista në dibrançe, duke respektuar e dëgjuar figura të ndritura dibrane që janë gjallë, figura që kanë zbukuruar përherë gjerdanin e panteonin e kombit shqiptar, gjithë nur e kulturë evropiane, manifestuan vlera e virtyte për të cilat kishim shumë nevojë ti sillnim në jetën tonë të përditëshme, për të kuptuar e për t'ju dhënë të kuptojnë edhe të tjerëve se e mençura fjalë që mendja në Dibër e bëri shtëpinë është një e vërtetë, e kështu ka qenë në jetë të jetëve.

Projekti u zbatua, e mesazhi u përcoll dhe u kuptua qartë: Rruga e Arbërit nuk do të ndërpritet kurrë deri në përfundimin e saj, -"kjo rrugë është thjeshtë një ndër angazhimet e mbajtura,- tha Z Olldashi, Ministri i Transportit, në Qeverinë Berisha."

Ka shumë kohë që nuk i kam thënë me kaq zë të lartë e me kaq besim të madh të gjitha ato çka kam shkruar më sipër, shumë kohë kishte e më kishte munguar shija e emocioni i një formacioni të tillë kuvendor e largpamës, por vetëm kaq më kish munguar, e ndoshta vetëm mua, por jo Dibrës, ajo e bëri "beli" si i thonë fjalës, e tregoi atë natë se ka ndryshuar por vetëm në rritjen e sofistikimin e kualiteteve të të bërit kuvend, përsosjen e rrugëve të përcjelljes së mesazheve. U lumturova pa kufi, të gëzohemi të gjithë sa jemi dibranë, të të gjitha Dibrave, se jemi e jemi edhe më të fortë e më të mençur se dikur, kemi jo vetëm justifikuar të qënit dibran, por shumë më tepër. Të lumturohemi të gjithë, sepse dibranët dijnë të bashkohen për çeshtje të mëdha e të rëndësishme, dijnë të sensibilizojnë jo vetëm njëri tjetrin e opinionin, por dhe më gjerë, e këtë e bëjnë me kulturë e finesë europiane.

Duartrokitjet mbyllën koncertin dhe mbajtën ndezur dritën jeshile për vazhdimin e përfundimin e rrugës së "Arbërit", vazhdimit natyral të rrugës së "Dibrës".

Ta gëzojmë e sa më shpejt të udhëtojmë mbi të!




Ministri Sokol Olldashi: Brenda këtij viti do tenderohen tre lote të tjera nga Bulqiza deri të Ura e Vashës dhe një lot nga Tirana drejt urës së Brarit. Do të mbetet një lot i fundit nga Ura e Brarit te Ura e Vashës ku përfshihet edhe një urë që është vepër arti, një urë që është shumë komplekse dhe që do marrë pak më shumë kohë. Sot nuk besoj të flitet më nëse është Rruga e Arbërit apo nuk është rruga e Arbërit. Rruga e Arbërit avancon çdo ditë, është tashmë një realitet dhe unë kam pasur fatin të jem ministër i Punëve Publike, kur kryeministri i këtij vendi ka marrë vendimin politik për ta ndërtuar këtë rrugë, pavarësisht kostos financiare. Nuk është e vetmja që po bëjmë në trevën e Dibrës. Jemi duke punuar në rrugën Peshkopi - Kolosjan - Kukës, jemi duke punuar për riveshjen e rrugës Peshkopi - Ura e Çerenecit dhe pastaj nga Çereneci drejt Steblevës dhe Librazhdit. Do fillojë shumë shpejt edhe rruga nga Ura e Matit - Fushë Muhurr dhe pas kësaj Dibra bëhet një trevë që do kapet me rrugë nga gjitha drejtimet.

Rruga Arbërit nr. 37

shënime

Pjesë nga libri i pa botuar
i autorit "Shënime në çadër"



Nga
Vesel HOXHA*



Pamje e majës 2678 m, në lindje të Bjeshkës së Shehut, në Malin e Korabit (Piramida Nr. 6).

Si në shtëpinë time…!

(Vijon nga numri i kaluar)

Kaluam me rradhë fshatrat e Vleshës, Kallës, Shullanit bashkë me përruan e Veleshicës, pranë mullirit të Jaho Kasemit dhe filluam malorën e Ploshtanit. Eshtë një malore e vështirë. Sa herë që e kujtoj dhe sot e kësaj dite, ndjej një ftohje ne zemër që më përhapet në gjithë trupin. Pa le më, kur fillonim maloren e dytë nga Ploshtani për tek sektori që nuk kishte të mbaruar. Kujtoj me habi dhe them me vehte se ai fshatari im, sikur të kishte patur parasyshë një malore të tillë, çfarë do kishte bërë e çfarë do kishte thënë!!! Ndërsa po i afroheshim lagjes Lite të fshatit Ploshtan, takojmë mikun e vjetër të gjeologëve, ndihmës mjekun e pasionuar të krahinës, Bajram Litën. Nuk patëm rrugë tjetër për tju shmangur, ai na bëri një "pritë të pakalueshme" dhe kësisoj ndaluam tek shtëpia e Bajramit. Me bujarin (mikpritësin) i ke llafet e shkurta. Ishte afruar koha e drekës, të lodhur ishim dhe pranuam. Tek Bajrami na zinte shpesh "dreka" e "darka", ndaj ndjehesha pak si në siklet, jo thjeshtë nga fakti se ai shpenzohej, por më shumë se u prishej "terezia e punëve" gjithë shtëpisë. Miku ta gëzon shtëpinë, por edhe të prishë terezinë thotë një fjalë e urtë. Shto këtu pastaj dhe bisedën e fundit me nënën e porositë e saj që akoma më tingllonin në vesh: Si ndihesh bir atje? Si në shtëpinë time nanë, i përgjigjem! Mirë -mirë më tha nana, shko rrallë e mos e tepro bir! Pikërishtë këtë të fundit mendoja edhe vetë, që të mos e teproja askund, as tek Bajrami me të cilin kishim lidhur një miqësi pa interes. Neve shteti na paguante dhe na kishte siguruar kushtet e jetesës dhe në male, kështu nuk duhej të shqetësonim fshatarët kohë e pa kohë, siç bënin jo rrallë disa nëpunës të tjerë që vinin nga qyteti i Peshkopisë apo gjetkë, duke shfrytëzuar postin partiak apo shtetëror nëpër shtëpiat e fshatarëve, dhe kur vinte puna që këto vinin për halle në qytet, bënin sikur nuk i shihnin, ose mjaftoheshin me një kafe, ndërkohë që ai u'a kishte shtruar, kishte lënë punën a ndonjë hall tjeter pa kryer, vetëm e vetëm për të pritur mikun, për sedrin që i ka munduar e i mundon një jetë të tërë! Me bujarinë që e karakterizonte për mikun, i çfardo rangu qoftë ai, na futi në dhomën e miqve siç e thërriste Bajrami. Na priti siç din të presë ai. Në bisedë e sipër më drejtohet: Nuk të shoh në humor si herët e tjera! Mos ke ndonjë hall? Pastaj ju drejtua dhe Xhelalit duke lënë të kuptohej se mos ne i fshihnim diçka! Po i them unë, e kam diçka dhe do të ta them. Ti je në shtëpinë tënde –vazhdoj Bajrami. Unë duhej të rrija ulur e Ju inxhinier të na bënit hyzmet (shërbim). Ndërkohë që unë po mendoja atë që desha ti thoja vjenë në dhomë e shoqja. Mirë se kini ardhur –na u drejtua ajo të dyve dhe duke takuar të parin Xhelalin pasi mua më konsideronte si të shtëpisë. Ke humbur Vesel, na mori malli, a mos je ngatruar me Bajramin? Kujton ky (Bajrami) se ti je nga ato Çidhnakët e vjetër dhe i kupton muhabetet me shifra që ka qëf të bëjë vetë, e ndoshta pa dashje je prek. Ti je djalë i ri, ke ardhur per punë këtu, nuk ke ardh të ndajsh kanun me Lumjanët. Jo, jo i them unë, me një buzëqeshje të lehtë, për ti dhënë me kuptuar se e kam me shaka, për ta ulur temperaturën e muhabetit. Bashkëshortja e Bajramit, ndjesë pastë, ishte një grua fisnike dhe nënë shëmbullore. Ajo kënaqej më shumë se Bajrami kur i venin miqtë, tjetër gje se ajo nuk e shprehte me fjalë, por me vepra linte për të kuptuar në shumë gjëra. Ajo ishte një burrneshë e vertetë. Në krahinën e Kalasë së Dodës, nuk ishte rregull që femrat ti nxjerrin, qoftë dhe për shërbim në odën e burrave, pale më për muhabet as që bëhej fjalë. Për mua ndoshta ky rregull përjashtohej, gjë të cilën unë e përktheja dhe si shenjë respekti. Shkurt, unë (dhe shokët kur nuk shkoja vetëm, pasi në të shumtën e rasteve shkoja dhe vetëm se ashtu kënaqej më shumë Bajrami, duke mos pas frikë e duke i dhënë muhabetit sa majtas djathtas deri në orët e vona të natës) ndjehesha i respektuar dhe si një pjestar i familjes. Deri këtu gjërat ishin në rregull. Rregulli prishej sipas meje kur familja e Bajramit në pritjen që më bënte, e tejkalonte atë, të qënurit si në shtëpinë time.

Hë thuaje se na plase –ndërhyri në bisedë si një Luznak i vertetë. Hë….-ç'farë xhevahiri do të na thuash. Unë nuk po gjej dot mineral hekuri e jo më xhevahir –vazhdova edhe unë bisedën në gjuhën që ka qefë Bajrami. Gjen ti gjen -mu drejtua mua duke luajtur kokën. A e di ti moj grua –ju drejtua ai bashkëshortes –se si i thonë një fjale popullore. Ç'farë lind nga macja gjuan mijë. Na ngacmove të dyve -hyri më në fund në bisedë Xhelali, duke i nxjerrë fjalët si me grep, e jo si unë e Bajrami që e gucnim muhabetin pa pushim. Këto janë të dy Çidhnak –ju drejtua ai gruas, me ta duhet kujdes. Nuk ta tregova pa qëllim atë thënien e vjetër unë. Këto e bëjnë muhabetin ndër mutaf, lere se çfarë thonë. Janë me shkollë këto –mbylli bisedën Bajrami. Erdhi koha dhe na shtruan drekën. A aaa …Bajram -i them unë -nuk i kishim kështu fjalët. Kështu mysafiri vritet. Nuk do rrimë pa bukë ne. Diçka do hamë. A po jo Xhelal –i drejtohej atij për t'ja miratuar, duke ja njohur natyrën jo kundërshtuese. Ja pra pse nuk isha në humor i them Bajramit. Si në shtëpinë time unë ndihem me një pritje tjetër. Bajrami e kuptonte mirë ku e kisha fjalën unë. Kështu e kishte Bajrami. Me muhabetin që i jepte mikut e shokut, ja hiqte të gjitha perdet, e bënte të harronte hallet. Ai u përshtatej miqve. Po te ishte miku bie fjala agranom, ai hapte fushatën e mbjelljeve apo korrje-shirjeve, po te ishte miku gjeolog, gjithë natën muhabet mineralesh kishe me të, hapte e mbyllte miniera, po të ishte miku mullixhi, bluante misër e grurë, e kështu me rradhë. Na priti e na përcolli vite me rradhë në atë derë bujare, në atë derë pushke e pene. Na priti në kohë të vështira e ditë të mira në kullën e vjetër e të re të Liteve. Na uli me dashuri në odën e tij të mysafyrëve, pa ju thyer zemra në asnjë rast, në ato lëkurat e mëdha prej leshi, të pastra si bora e Korabit e të bukura si vetë delët rudë, që i deshën e i duan si fëmijët. Na uli këmbëkryq rreth sofrës së tij të madhe të punuar me dru pishe. Tek shumë familje te Kalasë së Dodës, unë bashkë me shokët, gjetëm një mikëpritje bujare, ku puna dhe jeta larg familjes e solli të punojmë në ato anë e të bashkëjetojmë me to, të ndjehemi si bashkëfshatar të krahines se tyre vigane me bëmat e saj që nga thellësia e shekujve e gjerë në ditet tona. Dhe ajo më e rëndësishmja që ato më bënë të ndjehem në shtëpinë e tyre, si në shtëpinë time…!

Në pamunësi ti përmend të gjithë, nuk mund ti harroj ato pritje të ngrohta, ato pasdarke pa fund me biseda te embla e interesante te njerzve te mençur të kësaj krahine të njohur në të gjithë Shqipërinë, të cilët për mua ishin një shkollë e dytë, ku mund te veçoj midis tyre: Maliq Ganiun (Lika), Mahmut Hasanin (Perzhilla), Dut Perzhillën (babain e Shaban Përzhillës), Ibrahim Shehun (babain e Xhevat Shehut), Hamdi Feratin, Qerim Skejën, Rasim Shehun, Januz Vishën, Kamber Feratin, Muharrem Baloshin, Tosum Kolgjinin, Rrahman Sufën, Ali Jakupin, Veli kokën, Ramadan Himën, Jaho Kasemin, Eshref Vishën, Avzi Vishën, Hysen Përzhillën, Sherif Brikën, Sami Kokën, Sami Isanë, Abas Palushin, Vait Perzhillën, Safat Hoxhën, Enver Lamollarin, Veli Lamollarin, Mersim Selmanin, Xhabir Domin, Misim Dakun, Agim Dakun, Sabri Feratin, Esat Selmanin, Etem Madanen e shumë e shumë të tjerë, pa permendur këtu punonjësit e gjeologjisë që me mua i lidhte puna e përditshme në kërkim të mineralit.

Me të gjithë këto, me bukën e të cilëve jam ushqyer, me lidhë një ngjarje a një bisedë e pashlyeshme në mendjen dhe zemrën time. Këtë thesar popullor, ato biseda brilante, jam munduar ti shkruaj dhe ti botoj si një pasuri e çmuar për mua, e papërsëritshme, por me rrezatim, do të thoja, dhe për brezat që do të vijnë.

Nuk do ta harroj besimin që kishin tek unë ato njerëz të thjeshtë, ato njerzë të vuajtur, për bisedat që bënin haptaz kundra tufëzimit e shtegëtimit të bagëtive. Po të kishin frikë nga unë ato as që do guxonin ti hapnin muhabete të tilla në atë kohë. Një bisedë interesante që eshtë zhvilluar tek sektori i gjeologjisë në praninë time me një instruktor të asaj kohe apo drejtues të lartë të ndërmarrjes tonë, nuk e mbaj mend mirë, por mbaj mend mirë thelbin e bisedës, ku do perpiqem ta riprodhoj, duke vënë në provë kujtesën time, pasi shënime për të nuk kam mbajtur.

Ishte periudha e kulmit të tufëzimit. Ne si sektor kishim marrë urdhër që punonjësit që nuk do pranonin ta bënin atë, do të largoheshin nga puna. Urdhrin nuk e kishim marrë me shkrim. Ne një mbledhje në Bulqizë na ishte komunikur dhe kjo duhej zbatuar pa një e pa dy. Reagimet në popull ishin negative. Mungonte vetën demonstrata nëpër rrugë para kooperativës. Tufëzimi në rrëzë të Korabit ishtë një shaka e hidhur. Nuk mbante pilafi uji kur i thonë. Nga që unë isha vetë i lidhur me fshatin dhe me prindërit që banonin atje e dija reagimin e familjes time për tufëzimin, në veçanti të nënës. Kësisoj nuk isha aktiv dhe fshihesha pas pozicionit të specialistit, pasi ne të vertet ashtu paguheshim, në gjithë ekipet e ekspeditës, pamvarësisht se na trajtonin gjoja si kryetar ekipish. Kjo ju leverdiste, për të na shfrytëzuar dhe në aspektin organizativ, perndryshe duhej të vinin e të rrinin vetë, si ne, nëpër çadra e baraka, në ballë të vështirësive e larg familjes. Por e kishin zgjidhur problemin duke i nxjerrë gështenjat nga zjarri me duart e të tjerëve. Nuk vonon shumë dhe ankesat nga kooperativa me lista punëtorësh që nuk pranojnë tufëzimin erdhën. Të them të drejtën nuk ia vura veshin. Më dukej një gjë e padrejtë. Do thotë lexuesi tani eshte kollaj ta thoni, por në atë kohë nuk dihej si venin punët. Kjo eshtë më se e vertet. Me që ne nuk e zbatuam urdhërin e dhënë, nuk vonojnë dhe të deleguarit. Vijnë nga ekspedita, ndërmarrja dhe Komiteti i Partisë Rrethit. Personat në listë ishin njoftuar të gjithë. Midis tyre mbajë mend sidomos ato që diskutuan. Unë do të sjelle këtu dialogun e dy punonjësve që më kanë bërë përshtypje dhe më kanë ngelë në kujtesë. I ndjeri Njazi Hima nga Stredoku (Radomirë quhet sot) i vënë para përgjegjësisë tha: A ka ndonjë ligj që na detyron neve të lemë punën me që nuk pranojmë ta bëjmë tufëzimin! Ligj nuk ka u përgjigj i deleguari, asht direktivë partie dhe partia eshtë mbi të gjitha, është edhe mbi ligje! Pas kësaj Njaziu e mbylli fjalën duke thënë, delet nuk janë të miat, janë të babës. Nuk kam fuqi për ta urdhëruar. Ai eshtë kryetar i familjes. Mirë i thanë, do largohesh nga puna, poqëse nuk do ta bëjë tufëzimin familja Juaj! Pas Njaziut e mori fjalën Safat Hoxha nga Tejasi. Edhe ju nuk e keni zbatuar direktivën e partisë për tufëzimin. Kini delet pa tufëzuar dhe një dhi. Në fakt ashtu ishte. Safati kishte shume dele dhe të pa tufëzuara, por më që kishte shumë vëllezër dhe një pjesë e tyre nuk ishin në marrëdhënie pune me shtetin, ai kishte aftësi manovrimi falë dhe zgjuarsisë që kishte. Unë nuk kam dele fare. Kam vetëm një dhi, dhe ajo me ka ngordhur para dy ditësh. Ishte ngatrruar tek një pemë ku e kisha lidhur për kullotje. Le ta ndërpresë këtu vazhdimin e asaj mbledhje te pakëndëshme dhe absurde dhe të kthehem tek bisedat pas largimit të grupit.Të nësërmen, rastësia e solli që Njaziu dhe Safati të hanin drekë në të njejtën orë me mua në menxën e ekipit. Atë ditë Njaziu kishte veshur një xhamadan të bukur shumë sa më ra në sy mua dhe të tjerëve. Hë Njazi ç'kemi! Si vendose për tufëzimin –ishin dy pyetjet e mija te shpejta që i drejtova! Ndërkohë që po bëhej gati të më jepte përgjigjen -vazhdoj përsëri duke i thënë: E gëzofsh xhamadanin Njazi, e paske shumë të bukur! Ah inxhinier, e patë xhamadani! Pse i drejtohem me habi unë! Si të tufëzohen delet nuk ka lesh rud më, nuk ka dhe xhamadan! Ha, ha, ha….qesha pak dhe e mbylla bisedën me Njaziun. Hë-mo -mu drejtua Halit Koka, tekniku i ekipit, a e more përgjigjen e xhamadanit! E mora e mora, shoku Halit. Ndërkohë desha të ngacmoj pak dhe Safatin, por prita pak sa të mbaronte bukën. Përgatitu Safat se me sa duket e ke rradhën ti. Inxhinieri qenka në humor sot më dukët, ndoshta ka kap sonda mineral e ne nuk dimë gjë, se i mbanë sekret të gjitha. Safati nuk i ktheu përgjigje, por ishte i nxirë në fytyrë. Ai, as që mund ta mendonte, se ku do ta ngacmoja unë.

Si mbaroi bukën, ju drejtova atij me një qetësi të tillë, që ai të mos e merrte të qëllimshme pyetjen time, por si një diçka të rastit. Si ishte puna e dhisë, Safat, se punën e deleve e morëm vesh? Ajo kishte varë vehten Inxhinier! Kishte qenë në grup me Mehmet Shehun, mu përgjigj shkurt dhe me një farë serioziteti! Qesha pak nën buzë dhe nuk e zgjata më se nuk mbante pilafi më uji! Po ta kisha zgjat muhabetin Safati do të nxirrte xhevahire të tjera. Nuk i merrte hua Safati, i kishte hazër xhevap –kur thonë turqit. Kjo ishte dhe historia e xhamadanit të Njaziut dhe e dhisë së Safatit. Në përgjithsi punëtorët e asaj zone kishin një zgjuarsi natyrale. Mund të veçoj prej tyre edhe punonjës të tjerë si Enver Lamollarin, Veli Lamollari, Idriz Vishën, Shërif Feratin, Agim Feratin, Xhevat Shehun, Vasip Manallari, Adem Sufën, Adem Përzhillën, Skënder Domin etj.etj.

Edhe sot e kësaj dite, kur punët e profesionit e kërkojnë që unë të vete me punë në zonën e Malësisë së Korabit dhe veçanërishtë në pjesën e Kalasë së Dodës, ndjejë një gëzim të madh në zemër, më duket sikur po shkoj në fshatin tim, në shtëpinë timë të vjetër. Edhe pse shumë gjëra kanë ndryshuar, shumë njërëz kanë lëvizur, një pjesë e atyre që unë kam njohur kanë ndërruar jetë, përsëri diçka e fuqishme më bën që në atë zonë të ndjehem si ne fshatin tim, si në shtëpinë time!

traditë

Çezmat dibrane që shuanin etjen dhe ndiznin dashurinë

Nga: **REXHEP TORTE**



Çezma e Shahvecit



Çezma e Demçes

Dibra e Madhe është i dëgjuar edhe për nga burimet e çezmat e shumta, ku uji s'ka të ndalur shekuj me radhë.Kazmat dhe eskavatorët e sotëm që punojnë për të rregulluar gjësendi maleve ose në qytet, zbulojnë tubo qeramike dhe ujësjellës të vjetër për nga lashtësia, të gëdhendur në gur e të mbuluar me rasa guri, që e sjellnin ujin e pastër e të ftohët nga malet, apo kodrat e qytetit, duke e sistemuar këtë ujë me çezma nëpër tërë lagjet dibrane.

Këto burime uji të vendosur në çezma i kanë dhënë dhe po i japin jetë qytetit, sepse një vend pa ujë nuk ka as jetë. Edhe sot vazhdimisht dëgjohet jehona e gurgullimës së ujit të këtyre çezmave.

Në Dibër të Madhe është ndërtuar një numër i madh çezmash të ndryshme e të larmishme për nga bukuria dhe koha e ndërtimit.

Këto çezma sot e kësaj dite i kanë ruajtur emrat sipas ndërtuesve, ngjarjeve dhe vendit të tyre.Nga më të dëgjuarat janë Çezma e Demçes, Çezma e Shahvecit, Çezma e Namazgjarit, Çezma e Budulecit, Çezma e Copës, Çezma e Teqes, Çezma e Madhe, Çezma e Popit, Çezma e Tigvarcës etj.

Këto vendburime të ujit të ftohtë, ku trimat dibranë që arrinin nga anë të ndryshme, freskonin fytyrën dhe shpirtin nga rruga e largët, kanë edhe historitë e tyre të larmishme.

Më të moshuarit mbajnë mënd se ditën dhe orëve të mbrëmjes rrugët për në këto çezma nuk kishin të ndalur, sepse këtë e kërkonte maxhja dibrane për të gatuar dhe dëshira e sedra dibrane për ta mbajtur pastër shtëpinë, për vetë familjarët dhe për mysafirët që do të vinin.

Me këto çezma janë të lidhura edhe historitë tronditëse të fushatave luftarake të ashpra të armiqve që janë bërë gjatë shekujve për ta okupuar Dibrën e Madhe.Me ujin e këtyre çezmave luftëtarët trima dibranë, burra e gra, shuanin etjen dhe shpërlanin plagët dhe fashot me të cilat i lidhnin këto plagë.Me ujin e këtyre çezmave gratë e vyera dibrane lanin, shpërlanin dhe zbardhonin shtrojet, veshjet, qilimat dhe oborret e shtëpive.

Me ujin e këtyre çezmave gurbetçinjtë, udhëtarët dhe shtegtarët e rastit freskoheshin, pastroheshin dhe këndelleshin për të vazhduar më larg udhëtimin e tyre.

Me ujin e këtyre çezmeve fëmijët pas lojërave të tyre nëpër mëhallë laheshin, pastroheshin dhe futeshin në shtëpite, duke u kujdesur për të mos i ndotur ato.

Ujin e këtyre çezmave e përdornin dhe e përdorin edhe sot batëtitë e qytetit me të këthyer nga kullotat e fushës.

Në Dibër të Madhe ditën e natën shtegtari i huaj nuk e ka patur dhe nuk e ka vështirë të gjen ujë dhe të furnizohet me ujin e këtyre çezmave.

Shumë herë mbushja e ujit në këto çezma ishte edhe rast i mirë dhe i pështatshëm që vajzat dibrane të dalin nga shtëpia.

Çezmat dibrane shërbenin edhe si kuvende, ku tuboheshin vajzat dhe djelmoshat, por edhe të moshave më të rritura, dhe ndërsa pritnin radhën për të mbushur gjygimat e bucelat me ujë, kuvendonin e bisedonin për ndodhitë, ngjarjet, brengat dhe dëshirat e tyre.

Rrugës për në çezma, apo mu aty te çezma, të rejat dhe të rinjtë dibranë, shikonin njëri tjetrin, takoheshin e njoftoheshin dhe aty lindte dashuria dibrane, e pastër dhe e sinqetë si uji i kulluar këtyre çezmave.



Te këto çezma, përveç shuarjes së etjes lindte e ndizej edhe dashuria mes djelmoshave e vajzave dibrane.

Ishte bërë zakon, që kohë pas kohe, vajzat e një lagjeje shkonin e mbushnin ujë në çezmat e lagjes tjetër, për ta ndëruar edhe guston e ujit, por edhe për të mësuar dhe për tu informuar se ç'po ndodhte në lagjet e tjera të qytetit.


Rrjedhja e ujit në këto çezma ka bërë që të thurren shumë histori dhe të lindin shumë dashuri sokaqeve të shtruar me kalldërmë.Po të dinin të flasin këto gurë të kalldërmës dibranë, do të na i përshkruanin edhe dridhjet e shpirtërave të të rinjve e të rejave dhe flakët e dashurive të shumta dibrane që lidhen me çezmat dhe me ujin e tyre.

Shumë gra dhe vajza dibrane, në Ditën e verës dhe në Ditën e Shëngjergjit, edhe sot e kësaj dite, orëve të hershme të mëngjezit, shkojnë në këto çezma për të larë fytyrën me lule pranvere, sepse sipas ritit që besojnë kjo larje u sjell fat, shëndet e lumturi.

Të gjitha këto çezma dibrane janë ndërtuar me një mjeshtëri të rallë arqitektonike dhe funksionale. Gurët e mermerit mbështjellin tërë ambientin e çezmave, në murret e të cilave ka edhe dollapë, një ose dy varësisht nga vendi i çezmës.

Ndërtimi i ujësjellësave dhe futja e ujit në ambientet shtëpiake, nuk i ka cënuar fare çezmat në Dibër të Madhe .Ato ruhen e mirëmbahen me shumë kujdes dhe sa herë që ndodh të ketë difekt në rrjetin e ujësjellësit, dibranët me gjygima dhe enë në dorë drejtohen drejt këtyre çezmave, sikur dëshirojnë të thonë se çezmat nuk janë të harruara, ato janë dhe do të mbeten pjesë e pandarë e Dibrës së Madhe, e dibranëve dhe e jetës së tyre përplot me sfida.


Janë në qarkullim nga shtëpia botuese "M&B"



Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-19-6
Çmimi: 700 lekë

Mund ti porosisni
me tel:
+ 355 4 2 233 283

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-12-7
Çmimi: 1000 lekë





Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-14-1
Çmimi: 500 lekë

Mund ti porosisni
me email:
mbbotime@gmail.com

Botimet "M&B"
ISBN 978-99956-04-13-4
Çmimi: 1200 lekë



Si dhe libri **"Optika e Schmitt-it për Skënderbeun"**

Rruga Arbërit nr. 37

histori



OXHAQET E DIBRËS

Nga: **MOISI MURRA**

Në rast luftërash përfaqësuesit e oxhakut merrnin pjesë ashtu si dhe sanxhakbejt. Nga ana administrative dhe organizimi shoqëror, Dibra ndahej në "Topallti" dhe "Malësi". Megjithëse në Dibër ishte ngritur administrata osmane, në shkallë sanxhaku, pushtetin e ushtronin oxhaqet. Në Dibër Turqia Osmane njohu katër oxhaqe: Hoxhollin, Hysenagollin, Karahasanin dhe Xhilagën.

Në shek. XVI, veç kategorive të tjera të shtresës feudale osmane u shfaqen dhe ajanet (udhëheqës, parësi vendase), që shërbyen si ndërmjetës midis pushteti qendror turk dhe popullsisë shqiptare. Ajanet u pasuruan dhe u fuqizuan duke marrë me qira taksa shtetërore si dhe tatime bujqësore. Nga ana tjetër bënë krushqi me feudalë të vegjël, që grumbulloheshin rreth tyre si dhe mes njeri-tjetrit duke krijuan oligarkinë aristokrate, që në shek. XVI-II nga një grup manjatesh provincialë, bëhen klasë shumë e fuqishme në gjithë Perandorinë Osmane. Por, në vitin 1839, kur Sulltan Abdyl Mexhiti shpalli reformat (tanzimatin) "institucioni" i arjaneve u suprimua. Pas kësaj termi "ajan" mori kuptimin e senatorit, duke i "dhuruar qytetarinë" oxhakut.

Në fillim u emëruan në krye të oxhaqeve pashallarë dhe bejlerë të huaj. Më vonë, Porta e Lartë, duke parë se të huajt binin në konflikte të vazhdueshme me banorët vendas, i tërhoqi dhe në vend të tyre "dekretoi" në krye të oxhaqeve feudal shqiptarë. Këta, duke vënë në poste vartëse njerëzit e tyre, dashje pa dashje, krijuan themelet e pushtetit në sanxhakët shqiptarë. Ngritja e oxhakut si një hallkë ndërmjet pushtetit qendror osman dhe krahinave, në një farë mënyre kënaqi të dy palët: Porta e Lartë nuk merrej direkt me krahinat, por nëpërmjet oxhakut. Nga ana tjetër, dhe shqiptarët nuk do të kishin mbi kokë turq, por feudalë vendas. Veçanërisht Malësia me ngritjen e oxhaqeve dhe vendosjen në krye të tyre feudalë shqiptarë, nuk paguanin asnjë lloje takse, kishte hequr karakollët turke dhe jeta shoqërore rregullohej sipas zakoneve të vendit. Oxhakllëku ishte tokë (pronë) që u jepej për shfrytëzim komandantëve të fortifikatave, feudalëve vendas, të cilët duke përqafuar fenë islame hynin në rrethin e titullarëve të lartë të administratës ushtarake të Perandorisë Osmane. Oxhakllëku, si pronë, u jepej dhe disa bejlerëve dhe agallarëve për shërbime dhe nënshtrime ndaj Portës. Këtë kategori të sistemit të timareve, administratë osmane e quante oxhakllëk. Oxhaku kishte daulle dhe flamur, nuk mund të përmbysej dhe as të emërohej, Oxhaku trashëgohej. Nuk u jepej të huajve. Në rast të shuarjes oxhaku i jepej një të huaj për ta udhëhequr dhe administruar, por pa e njohur oxhak. Në rast luftërash përfaqësuesit e oxhakut merrnin pjesë ashtu si dhe sanxhakbejt. Nga ana administrative dhe organizimi shoqëror, Dibra ndahej në "Topallti" dhe "Malësi". Megjithëse në Dibër ishte ngritur administrata osmane, në shkallë sanxhaku, pushtetin e ushtronin oxhaqet. Në Dibër Turqia Osmane njohu katër oxhaqe: Hoxhollin, Hysenagollin, Karahasanin dhe Xhilagën.

OXHAKU I HOXHOLLIT

Nga katër oxhaqet e Dibrës, më i vjetër dhe më me influencë njihet Hoxholli, origjina e të cilit është e diskutueshme. Një grup studiuesish pranojnë origjinën e Hoxhollit nga fisi Doç i Lurës. Një grup tjetër thonë se origjina e Hoxhollit duhet kërkuar tek fisi Hoxhalli i fshatit Patin të rrethit të Matit. Haki Sharofi thotë se Hoxholli, sipas të gjitha gjasave ka origjinë turke. Me parashtresën e Sharofit pajtohet dhe autori i këtyre rreshtave. Hoxholli sundoi në Dibër plotë 253 vjet (1610-1863). Oxhak u njoh në vitin 1760. Pushteti tij shtrihej në të gjithë trevën e Dibrës. Me njohjen e tre oxhaqeve të tjerë pushteti iu rrudh dhe saktësisht i mbeti në Reka, Golloborda Lindore, Gryka e Madhe, Gryka e Vogël, Bulqizë dhe Maqellarë deri në Qafë të Qenokut. Më të përmendur nga oxhaku i Hoxhollit duket se kanë qenë Hysen Pashë Hoxholli, bejlerbej në Rumeli, i cili u vra në vitin 1714 në mbrojtje të Ujvarit. Gati në të njëjtën kohë përmendet dhe Abdurrahman Pashë Hoxholli, i cili ka qenë vali në Egjipt në 1711, në Bosnjë në 1714, në Budin në 1719, ku dhe u vra po në këtë vit. Pastaj vijnë Abas Pashë Hoxholli, që me 15 qershor 1818 iu dha grada e kapuxhibashit dhe qeverisja e dy Dibrave, në 1822 iu dha të qeveriste Sanxhakun e Ohrit. i biri Abas Pashës, Haki Pashë Hoxholli u bë pasha në vitin 1831, në 1833 e gjejmë myteselim të dy Dibrave. Në Luftën kundër Hajredin Pashës, korrik 1844 dhe pse u rreshtua përkrah tij, u akuzua si nxitës i kryengritësve të Dibrës. Për këtë, Sulltan Abdyl Mexhiti, e tërhoqi në Stamboll dhe më 28 tetor 1844 e arrestoi. Pas Haki Pashë Hoxhollit përmendet Mehmet Sadik Pashë Hoxholli, i cili qeverisi deri në vitin 1863 po me ata atribute si dhe parardhësit e tij. Mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit dhe qe anëtar i lidhjes për degën e Dibrës, por i rreshtuar në krahun prosulltanist. I fundit i oxhakut të Hoxhollit përmendet Ali beu, djali i Mehmet Sadik Pashë Hoxhollit, i cili në shkurt të 1899 kryeson kuvendin e Dibrës dhe në tetor të 1912, në një tubim që organizohet në Dibër të Madhe për çështjen e gjuhës shqipe këmbëngul për të mbajtur alfabetin arab. Shtresa që përfaqësonte Hoxholli, madje dhe oxhaqet e tjerë të Dibrës, domosdo që do të binin në konflikte me masat e gjera të popullsisë. Kështu, bie fjala, në shkurt të 1833 banorët e Qidhnes të udhëhequr nga Vesel Lusha e Sali Noka, u hodhën në kryengritje për shkak se refuzonin të regjistronin ushtarë nizam. Zëvendës myteselimi i Dibrës, Dalip bej Hoxholli, në krye të një trupe të zgjedhur ushtarake, rreth 8000-10000, që ishin të përqendruar në Dibër të Madhe dhe Manastir, sulmoi dhe i goditi kryengritësit çidhnak, duke i detyruar të tërhiqen në Mat. Oxhaqet shpesh herë luftonin dhe kundër njeri-tjetrit e jo rrallë dhe kundër Turqisë. Kështu, në korrik të vitit 1835 Haki Pashë Hoxholli, Abdurrahman Pashë Tirana, Mahmud Pashë Prizreni marshuan në krye të forcave të tyre për të hequr me dhunë myteselimin e Shkodrës Hafiz Pashën. Po kështu, në Luftën e Drinit, korrik 1844, Haki Pashë Hoxholli luftoi kundër forcave të Hajredin Pashës. Pashai i Dibrës ishte i detyruar të luftonte kundër Hajredin Pashës, sepse tre muaj më parë, vëllai i tij, Dalip bej Hoxholli, kishte mundur në fushë të Tetovës Rexhep Pashë Tetovën, vëllain e Hajredin Pashës. Në të vërtetë kjo ka qenë politika e Portës së Lartë: shqiptarët kundër shqiptarëve. Hajredin Pasha, siç u theksua më lartë, ka qenë nga Tetova. Gjatë muajve shtator - dhjetor 1844, kur dhe qëndresa dibrane ra, kreu masakra bizantine kundër popullatës duke bërë shkrumb e hi 36 fshatrave të Grykës së Vogël, Grykës së Madhe dhe Bulqizës. Sulltan Abdyl Mexhit e thirri në Stamboll dhe në fund të dhjetori të 1844 e eleminoi fizikisht. Edhe Jusuf bej Hysenagolli, në korrik të vitit 1812, u ndesh me trupat e Ali Pashë Tepelenës, që komandoheshin nga Meço Bano, Kapllan Pashë Toptani, feudalet e Matit dhe kapidani i Mirditës. Hysenagolli ashtu si shumica e feudaleve të veriut nuk e shihte me sy të mirë shtrirjen e Vezirit të Janinës në veri, prandaj dhe për këtë Mustafa Pashë Bushatlliu dhe feudalët e tjerë gegë e ndihmuan Jusuf bej Hysenagolli në arritjen e fitores. Ndërsa Karahasani, Ahmeti dhe i biri, Jusuf, dolën hapur kundër Turqisë, i pari me mendje si pjesëmarrës e anëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Jusufi me mendje e pushkë.

Oxhaqet e Dibres kane pas krushqi njëri me tjetrin. Abas Pashë Hoxholli i Dibrës kishte dhënë një vajzë tek Bushatllit, një tek Mahmud Pashë Verlaci në Elbasan, një (Zerina Hoxhollin) tek alltunet e Kavajës, një tek Karahasanin i Brezhdanit. Këtë gjë kishin bërë dhe Karahasani, Hysenagolli e Xhilaga. Por, nuk u kanë shpëtuar dhe konflikteve, që ngrinin krye, veçanërisht për ndikimet mbi fshatrat që merrnin të ardhurat. Konflikte janë shënuar në mes të Hoxhollit e tre oxhaqeve të Dibrës së Poshtme. Rasti me tipik dhe me çnjerëzor është ai i Abas bej Hoxhollit. Në vitin 1800, Abas bej Hoxholli, grishi në një darkë në shtëpinë e tij, në Oranik (Sheher të Dibrës) krerët e oxhaqeve të Dibrës së Poshtme: Ahmet bej Karahasanin, Ahmet bej Hysengollin dhe Sulejman bej Xhilagen. Dy të parët sapo arritën në Spas u therën nga njerëzit e Abas Bej Hoxhollit. Shpëtoi Sulejman bej Xhilaga, që ishte nënpunës në Peqin, por dhe këtë pas një muaj dërgoi njerëz dhe vrau. Më vone, forcat e përbashketa të tre oxhaqeve të Dibrës së Poshtme, Hysenagollit, Karahasanit dhe të Xhilagës, të prira nga vajza e Ahmet Karahasanit, Bedria, sulmuan Hoxhollin, në sarajet e tij dhe u hakmorrën qenëshe. Populli këndoi:

"Moj Bedrie e lumja bijë
Vune kamën në zengji
More gjakun e vllait të ri ''

OXHAKU I KARAHASANIT.

Karahasani, si oxhak u njoh aty nga viti 1774. Origjina e tij është nga Shoshajt e Dukagjinit. Nuk dihet se në ç'vit ranë në Zenisht të Matit, ku themeluan dhe një lagje me emrin Shoshaj. Njëri ndër ta, Kurt Shoshaj, bashkë me katër djemtë lëvizi dhe nga Zenishti dhe u ndalua në Brezhdan të Dibrës së Poshtme. Ai që i dha emër fisit qe Hasani i I-rë, i cili për trimëritë që tregoi në luftën ruso-turke, 1768-1774, mori nofkën Karahasan (Hasani i Zi) dhe fermanin që njihej oxhak. Pas Hasanit të Zi (Hasanit I-rë) emër bëri Hasani i II, Ahmeti i I-rë, Bedria, Ahmeti i II dhe Isufi. Edhe Karahasani, si të gjithë oxhaqet e tjerë u fuqizua si nga ana politike e domosdo dhe nga ana ekonomike. Pushteti i tij feudal shtrihej në fshatrat: Brezhdan, Rashnapoje, Ushtelencë, Zdojan, Kuben, Cerjan, Kishavec, Rreth Kale, Tomin, Muhurr, Luzni dhe pas vitit 1844 dhe Selishte, e cila u shkëput nga Oxhaku i Zogollit të Matit, për arsye se Haxhi Pashë Sakati (Zogolli) i erdhi në ndihmë Hajredin Pashës. Paralel me pushtetin administrative të Karahasanit, në fshatrat e përmendura më lartë, vepronin Teqja e Tominit dhe ajo e Brezhdanit. Sarajt e Karahasanit rrinin plot e për plot me njerëz që shërbenin aty si: hyzmetqar, kafshar, barinj, furrxhinj, kafexhinj, njerëz që merreshin me punët bujqësore dhe të vjeljes së taksave, hoxhallarë, imamler, njerëz që dinin shkrim e këndim e njerëz të armatosur. Me fjale të tjera, jeta dhe qëndrimi i Karahasanit ishte jeta dhe qëndrimi i një familje feudale tipike orientale, siç ishin dhe Hoxholli, Hysenagolli dhe Xhilaga. Edhe Karahasani kishte lidhje të forta me seren e rangut të tij brenda dhe jashtë Dibrës. Brenda Dibrës kishte lidhë krushqi me Hysenagollin dhe Hoxhollin. Jashtë Dibrës kishte lidhë miqësi me Bushatlliun e Shkodrës, bejlerët e Tetovës, bejlerët e Pejës dhe oxhakun e Çelajve të Patinit e Ali Pashë Gucinë. Nga tre oxhaqet e Dibrës së Poshtme Karahasani citohet të ketë mbajtur qëndrim shumë të egër ndaj fshatrave të semtit të tij. Hapja e burgut në oborrin e tij, vrasjen në pabesë e fisit të Tonuzit (Karahasani dhe Tunuzi ishin një vëlla), sjelljen e ujit të pijshëm me bulira nga Luznia, tregon më së miri egërsinë shembullore të Karahasanit. Këta si dhe taksat e rënda që u merrte fshatarëve e çuan Karahasanin në konflikte të herëpashershme me fshatarët e Luznisë, Muhurrit dhe Katër Grykëve, konflikte në të cilët Karahasani doli i humbur. Kjo tregonte se pozita e tij në veçanti, por dhe e oxhakëve në përgjithësi, në mesin e shek XIX, nis të bjerë dukshëm. Deri në qershor të vitit 1878 Karahasani nuk përmendet për ndonje punë të mirë në interes të çështjes kombëtare shqiptare. Po pikërisht në qershor të 1878, Ahmet bej Karahasani, rreshtohet me krahun atdhetarëve të shquar shqiptarë, Abdyl bej Frasherin, Iljas Pashë Dibrën, Ali Pashe Gucinë, Sulejman Vokshin e të tjerë, për themelimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe shtrirjen e autoritetit të saj në të gjitha trojet shqiptare. Akti për organizimin e ushtrisë kombëtare shqiptare dhe vendosjen e tyre në vendet e duhura mban dhe firmën e Ahmet bej Karahasanit. Por, për dreq, fati e godet fortë e dhimbshëm Ahmet bej Karahasanin. Ata ditë që ishte në Prizren i vdes gruaja, vajza e Ali Pashë Gucisë dhe djali i vetëm. Kthehet në Brezhdan dhe pas këtyre ngjarjeve të trishtueshme nuk e gjejmë të përfshirë në veprimtari kombëtare, gjë të cilën do ta vazhdonte e do ta bënte me devotshmëri e përkushtim atdhetar i vëllai i tij, Isuf bej Karahasani. Isuf beu mori pjesë në luftën e Nishit, 1877; në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, 1878; në kuvendin e Dibrës, shkurt 1899; ne Kongresin e Dibrës, korrik 1909 dhe në kryengritje kundra turke të viteve 1909-1911. Shkurt: me veprimtarinë atdhetare në tre dhjetëvjeçarët e fundit të sundimit turk në Ballkan, Isuf Karahasani lau jo vetëm fytyrën e oxhakut të tij, por në një farë mase dhe të tre oxhaqeve të tjerë të Dibrës. Me vdekjen e Isuf bej Karahasanit, në fund të dhjetorit 1910, shuhet dhe Oxhaku i Karahasanit, ashtu siç shuhet një vatër me prush me një gjym uji.

(Vijon numrin e ardhshëm)

kritikë letrare

Subjektet nuk janë aspak spektakulare, por vijnë si produkt i jetës së përditëshme e rreale, anipse dramatike të fshatit. Nostalgjia e shkrimtarit e mbush lëndën tejendanë, duke u bërë kështu, fibra e tekstit të narrativës së tij.

Përkthyesi i Kadaresë prezanton Ramiz Gjinin në Rumani

Para disa ditësh doli në Bukuresht vëllimi "Atdheu prej dëbore" i shkrimtarit shqiptar Ramiz Gjini. Vëllimi përmbledh tregimet më të mira të këtij prozatori, i cili banon në Amerike prej gati dhjetë vjetëve. Përkthyesi i tregimeve të Ramiz Gjinit është Marius Dobresku, shkrimtar dhe gazetar rumun, fituesi i çmimit "Penda e argjendtë" në vitin 2006.

Dobresku është gjithashtu i njohur si përkthyesi i Ismail Kadaresë në gjuhën rumune.

Vëllimi në fjalë përmbledh 15 nga tregimet më të arritura të këtij shkrimtari shqiptaro-amerikan dhe ka një parathënie mbi Ramiz Gjinin dhe veprën e tij.

"Nëpërmjet tregimeve të tij, kam njohur një shkrimtar të formuar jashtë Shqipërisë, por të lidhur kryekëput me realitetet e saj", shkruan Dobresku në parathënie.

Letërsia shqipe ka njohur mjaft rastë të tilla, duke filluar me klasikët, modernët dhe duke mbaruar me autorët e sotëm. Dhe nga kjo dukuri ajo nuk humbi asgjë, përkundrazi.Shembujt e Lasgushit, Mitrush Kutelit, Kadaresë e dhjetëra te tjerëve janë shumë të njohur".

Tregimet e Ramiz Gjinit kanë një parfum nostalgjik, janë të mbushura me kujtimet e vendeve dhe njerëzve të afërt të mbetur shumë të gjallë në memorien e autorit.

Libri është botuar nën kujdesin e organizatës Lidhja e Shqiptareve të Rumanisë, të kryesuar nga deputetja Oana Manolesku.

Lidhja e Shqiptarëve të Rumanisë boton, ndërmjet Shtëpisë Botuese "Privirea" dhe me financim



Tregimet e Ramiz Gjinit kanë një parfum nostalgjik, janë të mbushura me kujtimet e vendeve dhe njerëzve të afërt të mbetur shumë të gjallë në memorien e autorit.

nga qeveria rumune, libra te shkrimtareve shqiptarë, pavarësisht nga vendi ku ata jetojnë dhe krijojnë.

Vitin e kaluar doli tek "Privirea" një vëllim me vjershat më të mira të poetit të ri Ermir Nika, kurse sivjet organizata e shqiptareve rumune do të organizoje një simpozium të kushtuar poetit të madh Lasgush Poradeci.

Parathanie e librit "Atdheu prej Debore", botuar në rumanisht

Nga: **MARIUS DOBRESCU**

Kur e perktheva tregimin e parë të Ramiz Gjinit, pata një stepje, pasi nuk kisha dëgjuar kurrë për këtë shkrimtar.

Tregimet shumë të bukura të librit "Atdheu prej Dëbore", ngase qenë shkruar me dorën e sigurtë të një shkrimtari profesionist, nuk dija si t'i trajtoja. Pastaj, duke marrë në dorë njërin pas tjetrit vëllimet e tij të botuara viteve të fundit, bindja mu forcua më tepër. Kështu, unë kuptova se kisha të bëja me krijime të një shkrimtari bashkëkohor të formuar jashtë Shqipërisë, por të lidhur shumë ngushtë me karakterin e veçantë të realiteteve të saj.



Letërsia shqipe ka njohur raste të ngjashme me shkrimtarë klasikë, modernë si dhe bashkëkohorë, shkrimtarë, vepra e të cilëve, është një pasuri e paçmueshme që nuk duhet humbur. Sidomos, kam parasyshe ketu, Lazgush Poradecin e Mitrush Kutelin, tashmë të njohur nga të gjithë.

Por le të kthehemi tek Ramiz Gjini. Porza e tij rrezaton një nostalgji të pafund për kohë e vende të lashta e të munguara. Ndjesitë e tij të pashmangshme e të fuqishme prej aktori dhe shkrimtari, përcillen përmes një sensibilizimi të personazheve vdekatarë.

Mjafton të përmendim në këtë vëllim të përkthyer në rumanisht tregimet "Atdheu prej Dëbore", apo "Dërgesa e Zotit, për të kuptuar forcën sugjestionuese të artit të tij." Të dy këto tregime, na fusin në një botë të mrekullueshme fëmijërie, ku gjithçka është e mundëshme dhe asgjë nuk është e ndaluar.

Toni i narrativës, në këto dy tregime, është i ngrohtë e gjith afrimitet. Duke pasqyruar me thjeshtësi naivitetin e moshës së fëmijërisë, prozatori Ramiz Gjini, na fut në një botë, ku gjithshka duket si një breshër kristalesh i shpërndarë me shpirtëmadhësi mbi realitet tona pragmatike e egoiste.

Në librin "Atdheu prej dëbore, që unë kam përkthyer, gjendet një seri tregimesh me subjekte nga jeta fshatarake. Ngjarjet ndodhin në një fshat të quajtur Biboll, një vend që aktualisht, nuk gjendet në asnjë hartë të botës, por gjendet në mendjen e shkrimtarit.

Personazhet janë tërësisht autentikë e plot jetë. Ata flasin në dialektin e tyre të pasur lokal, pak të vështirë, por jashtëzakonisht plastik dhe shumë të gjallë.

Shkrimtari ka zotësinë të shpërndajë e të sjellë në masa të sakta gjithë elementët e një tregimi modern, brenda te cilit, nuk mungon as melankolia, as humori, as sarkazma dhe as mençuria popullore.

Subjektet nuk janë aspak spektakulare, por vijnë si produkt i jetës së përditëshme e rreale, anipse dramatike të fshatit. Nostalgjia e shkrimtarit e mbush lëndën tejendanë, duke u bërë kështu, fibra e tekstit të narrativës së tij.

Kurse ato dodhi të jetës amerikane, që gjenden në tregimet e tij, janë shprehje e përballjes së Gjinit me realitetin në të cilin aktualisht ndodhet dhe që ai e ka adoptuar. Ky realitet është diametralisht i kundërt me atë të një fshati të largët ballkanik.

Konfrontimi me realitete e mendësi të tilla të ngritura në përmasat e një lufte të vërtetë, është përshkruar në tregimin "Kthimi i Dajës Alem".

Në këtë prezantim të shkurtër të këtij vëllimi, duhet theksuar se proza e Ramiz Gjinit, tregon qartë, që letërsia shqipe, nuk shkruhet vetëm në Shqipëri, Kosovë apo Maqedoni. Ajo shfaqet edhe në diasporë, madje, asaj i shtohet një stimul shtesë: vuajtja e të shpërngulurit; nostalgjia e emigrantit të larguar nga atdheu, e shtyn atë edhe më tepër drejt letërsisë.

Në rastin e veçantë të Ramiz Gjinit, ajo vjen me rezultate të admirueshme.

Kongresi i Dibrës dhe Hafiz Ali Korça

(Vijon nga faqja 7)

Z. Qenan B. Manastiri: "Të mos harrojnë Kretën (Gjiridin) Si u kndua telegrafi për fjalën (besa) Z. Elezovçi (Shkup) mori fjalë duke e thënë: "Firma të mos i vihet (kongresa konsitutional Shqiptare) por le të shkruhet (Kongresa e Rumelisë a e Maqedonisë) sepse ktu në kët kongres s'ndodhen vetëm shqiptarët por ka edhe të tjere, si un serb e kush Bullgar e të tjerë. Veç ksaj fjala, , besa"" përdoret vetëm në Shqipëri e jo gjetkë. Me gjith këtë kjo fjalë n'Europë njihet si nji lloj barbazmë"

Ky shkrimtari: "Zoti Elezoviç me kët fjalë po na poshtëron, kjo fjalë në gjuhët t'Europës përdoret: (parol d'honueur) Shqiptarët kurdoherë që kanë dhënë dhe japin besën tretin shpirtin, pra Z. Elezoviç fjalën le ta marrë prap se çnderon krejt Shqiptarët. Na Shqiptarët besën e nderojmë"

Mufti Rexhepi, Z. Hafiz Aliu kto fjalë i a përplasën mjaft Z. Elezoviç, biseda u ashpërua tepër, së fundi Z. Hafiz Aliu: "Z. Elezoviç, me fjalën Maqedonja nuk di se ç'do të fitoni? Maqedonja a nuk është djepi i vjetër e kërthiza e Shqipërisë? Gjyshët e stërgjyshët tonë, pallazgët a nuk kanë qënë populli i Maqedonjës? Z. Haxhi Ibraim B (Shkup) Z. Halim Bej, Qenan Bej e të tjerë folën mjaft për mbi këtë dyk e thënë: si kundër që tha dhe vllaj jonë Z. Hafiz Aliu populli i Maqedonisë ka qënë gjithnjë Shqiptarë, pra Zotëria e juaj e hartës jepni ç'ngjyrë të doni, na jemi Shqiptarë në një copë tokë …

Z. Shanof(Kosturi) "Besa në Shqipëri është fjalë e vjetër, unë të mos i u besonja shqiptarëve në besë si nji bullgar, që jam nuk vinja këtu pra besën e shqiptarëve e shënjëtroj me gjith shpirt. Bisedimi mori fund, telegrafi për Kretën u hoq.

Mbledhja e III e Kongresit

Z. Riza. B . Shkodra: "Të kërkojmë nga qeveria qi të ndreqën kufitë midis Serbit e Malit të Zi dhe t'i jepët fund grindavet e vrasjevet që ngjajnë përherë.

Shkrimtari i kësaj librës: "Fort mirë të bëhet, por (ndreqje kufish) të mos kujtojmë.

Z. Mustafa Arif Selaniku: "Po dalim jashtë programit, po kapërcejmë kufin e kompetences. Mbi këtçështje foli tepër Z. Qenani, Z Suhejli së fundi fola dhe unë përsëri dyk e thënë: "Kemi të drejtë të bisedojmë, ti ndreqim (ti ndrëojmë…)

Pastaj Z. Riza Shkodra: "Fjalën ndreqjen e kufive e mora prap tha: Z. Qenan përsëri foli mjaftë; bisedimi u ashpërua. Me hall të madh kjo bisedë mezi u mbyll.

Z. Hafiz Ali Korca: "Ndër ata fshatra që s'ndollen shkolla fillore me domos të çelën edhe ndë gjith shkollat e Shqipërisë, gjuha kombëtare të këndohet. Fqinjet tona nga an' e arësimit kanë arrirë shkallën më të lartë. Na për fat të keq kemi mbetur si populli i Afrikës së mesme. Me gjithatë, në Shqipëri kurse tërë gjuhët mësohen gjuha jonë përse të mos mësohet?

Kjo kërkes e zotërisë së tij midis kongresës plasi si një dinamit i pa pandehur, filloj një poterë e bërtitje e përdryshme në të gjith anët.

Z. Sudi: " Me ç'shkronja do të mësohet? Se në gegëri shkronjat llatinë s'i do as kush.

Z. Hafëz Ali: "Zotërinj! Ju lutëm shkronjat mos i përzini, vetëm këndoni.

*Z. Qenan: K*emi ardhur për të sjellë nji bashkim midis elementave, pra të përzihemi me shkronjat atëherë do të qitim një ngatresë në mes të gegëve e të toskëve. Do të ishte më mirë letrat ti linim pas vullnetit të si kujit.

Z. Riza: Neve Shqipnija nuk na duhet mjaft kena gjuhën e Ali Osmanit"

Z. Hafëz Ali Korca : "Ska të drejtë Z. Riza të përzihet në çështjen e gjuhës kombëtare.

Z Riza B. Shkodra: "Përse? Unë a nuk jam Shqiptar?

Z. Hafëz Ali: "Të ishit Shqiptarë prej gjuhës amtare do të mos tregonin kaqë merzi.

Z. Mufti Rexhepi: "Bubuja sa turp i madh qysh thuhet s'na duhet gjuha kombëtare? Domosdo bashkë me fenë ta mësojmë (trokitje duarsh)

Ky shkrimtari: "Një sent që ligji themeltar e ka pranuar e thëna s'e duam, vjen kontra ligjit e ndjenjave kombëtare. Riza Beu në dashtë le të mos e kndojë.

Z. Riza: "S'them për vehtën t'ime por Shkodra nuk e do"

Z. Seid Kruja: "Përse nuk e dashka Shkodra na do të këndojmë. Turqishtja s'na volit në gojët, pasha Zotin na do të këndojmë shqip"

Z. Haxhi Muhamed Vlora: "Nëpër librat shqip shohim disa fjalë kontra besimit e moralit prandej s'e duam"

Z. Hafiz Ali: "Zotërinj! Kësi fjalësh, librat arebishte persishte e turqishte kanë më tepër, apo nuk po i këndojmë. Si të këndohet gjuha, nëpër shkollat domosdo do të futen librat e zgjedhura (me zë t'unjët) aman Z Haxhi të lutëm mos qit ngatresa, u zbut Z. Riza Kurse këndohet turqishtja, shqipja çduhet?

Z. Qenan: "Qysh u bëka vetëm me turqishtën? Nevojat shkollore janë aqë të shumta sa në gjuhën amtare edhe nuk munden të plotësohen.

Z. Riza: 'Bashkë me disa baraktarë ç'thoni mor shokë? A na duhet?

Ky shkrimtari: "Ah o zot i madh ! Gjuha e mamës, zërthi i bukur i babës po merret ndër këmbë. Goja e jonë që s'pranon as do një gjuhë të huaj, qysh do të flaës gjuhën e huaj. Bubuja po shahet gjuha ëngjëllore! Vëllazër brumi s'ndron. Na Shqiptarë kemi qënë Shqiptarë, jemi prap, Shqiptarë do të jemi. Na gjuhën nuk e lamë të vdesë"

Z. Seid: "Domosdo do ta këndojnë"

Z. Murad Jakova: "Do të këndojmë po"

Z. Jusuf B. Kara Hasani: "Nuk heqim dorë nga gjuha e jonë. Gjith krerët e malësorëvet kanë zbritur dhe janë mbledhur në xhami të madhe, gjith populli duan ta çpërndajnë mbledhjen.

Qenan Manastiri: "Shokët qi kemi jashtë të drejtën a nuk na e lanë neve? Tani kurse kemi vazhduar mjaft dhe kemi ardhun në fund të bisedimit, a nuk është turp të përndahemi kot më kot? Le populli jonë por edhe fqinjët do të qeshin me ne, me ç'sy dhe faqe do të kthehemi? Ardhëm me nji bujë të madhe e të kthehemi me shoqë për ujë!. . bubuja sa turp!. .

Z. Riza: " Më s'besojmë vetëm të vërtetojmë të katër pikat origjinale dhe t'ikim. S'kemi detyrë tjetër.

Z. Qenan: "Zotërinj? Kemi liri të plotë, s'ka të drejtë kush të na caktojë kufi për bisedim. Mentimet e larta të kombit bujar nuk mundet t'i marrë ndër këmbë as kush.

Z. Hafiz Ali: "Që ditën e parë së mbledhjes së përgjithshme pata thanë që kurse qëllimi i mbledhjes paska qënë vetëm për të vertëtuar këto katër pika, nuk ishte e nevojshme të mbidheshim por i kishin vertetuar nëpër viset q'ishin, këtu luan nji gisht!.

Z. Myfti Kara Rexhepi: "Sa çudi! Dhe unë tham si thotë Hafiz Aliu, këtu ka nji gjishtë që, bisedimet tona të ditës, na i përmbys natën. Çështjet e përfënduara qysh u marrkanë prap në bisedë, pale gjith e gjith si i hethkan poshtë krejt.

Z. Riza: Veç katër pikave origjinale, s'ka….

Ky shkrimtari: "Ç'është kjo punë! A kështu qe besa që lidhëm. Besën t'onë po e marrim vetë nëpër këmbë. Sa punë e tmerçme! Oji ç'rrezik na gjeti! Vazhdim! Vazhdim! Një poterë! Zëra të ndryshëm me gjak të nxehtë.

Z. Jusuf Bej Kara Hasani (nga malsija) "Kemi dhënë besën o Mufti efendi mbaj qetësinë!. Do t'vazhdojmë…"

(Vijon)



Portrete të artit dhe kulturës dibrane

EDLIRA GJONI (NOVAKU)
- vajza virtuoze dibrane në violinçelë

Nga: **NAIM PLAKU**

Eshikoni këtë grua të qeshur e të bukur, që me aq pasion e dashuri jep mësime në violinçel dhe përgatit talentet e reja tek shkolla e mesme artistike "Jordan Misja", një shkollë me kaq tradita, që i ka dhënë vendit kaq shumë artistë? Edhe ajo vetë ka qenë dhe është një talent i kësaj shkolle, i kësaj vatre të madhe kulture. Është ajo vajza e vogël dhe e brishtë, bijë e mësuesit të nderuar Fiqiri Novakut, që erdhi në këtë shkollë kur ishte vetëm gjashtë vjeç. Është ajo vajza e bukur dibrane ku kishte spikatur talenti në fushën e muzikës dhe ndoshta, kaq e imët dhe e vogël atëherë, me gishtat e saj të hollë do të nënshtronte për vite me radhë violinçelin e madh duke mbushur arenat e artit shqiptar e botëror plot tinguj e melodi. Është ajo vajza e dikurshme dhe gruaja e sotme që do të luante me virtuozitet në formacionet orkestrale veprat muzikore që nga ato më të thjeshtat e gjer tek veprat klasike të kompozitorëve të mëdhenj dhe talenti i saj do të shkëlqente që nga skena "Virtuozët e Tiranës" e gjer tek ato të Spanjës, Austrisë, Francës,Italisë, Zvicrës, etj.

Ja tek e kemi në vitet e hershme të rinisë së saj, atëherë vetëm 15 vjeç, duke luajtur në orkestrën "Virtuozët" të drejtuar nga mjeshtri i madh i skenës shqiptare, Zhani Ciko, duke dhënë shfaqje në skenat më në zë të Evropës e më gjërë. Vit pas viti e shohim përkrah mjeshtërve duke u shquar në komplekset orkestrale e sidomos në atë të harqeve dhe duke u nderuar me çmime kombëtare e ndërkombëtare. Ja tek e patëm edhe pak ditë më parë, në prill të këtij viti në stinën koncertore pranverore mes artistëve të huaj në një sërë koncertesh në mjediset e ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë e Sporteve, tashmë mësuese e përgatitjes së talenteve të reja në shkollën "Jordan Misja". Edlira Gjoni debutoi me shumë sukses si pjesëtare në orkestrën e harqeve të drejtuar nga Desar Sulejmani në koncertin e zhvilluar me 9 prill 2009 në nderim të 200 vjetorit të vdekjes së kompozitorit të madh gjerman Hajden.

Edlira Gjoni (Novaku) ka mbaruar studimet e larta në Akademinë e Arteve të Bukura. Ne dibranët e njohim fare mirë, sepse ajo ishte bija e një mësuesi të talentuar të gjuhës dhe letërsisë në gjimnazin e qytetit të Peshkopisë, që u nda nga jeta në moshë të re, duke lënë pas një përvojë të çmuar didaktike, të pasqyruar edhe në disa botime pedagogjike të kohës. E njohim fare mirë se për disa vite me radhë, nga viti 1997 e gjer më 2002 ajo drejtoi sektorin e muzikës në qendrën Kulturore të Fëmijëve në qytetin e Peshkopisë dhe ishte udhëheqëse artistike e ansamblit të fëmijëve. Atë e njohin të gjithë dibranët, jo vetëm si një violinçeliste virtuoze, si një mësuese e pasionuar, por edhe si një krijuese të disa veprave muzikore e të shumë këngëve e melodive orkestrale për fëmijë. Në këto vite Edlira bënte pjesë edhe në orkestrën e Qendrës Kulturore dhe të Estradës së Peshkopisë ku shquhej për korrektesë e përgatitje profesionale në veglën e saj. Fëmijët e Dibrës e njohin dhe ushqejnë dashuri e mirënjohje të pakufishme për mësuesen e tyre, që i rriti dhe i frymëzoi për ta zhvilluar më tej talentin e tyre. Nuk është rastësi që nga gjiri i kësaj Qendre kanë dalë vazhdimisht orkestrantë të talentuar, sepse ajo diti t'i zbulojë, t'i thithë e t'i edukojë talentet e reja të muzikës e të artit në përgjithësi.

Në vitin 2002 Edlira ka filluar punën si pedagoge në shkollën "Jordan Misja" në Tiranë, ku vazhdon edhe sot po me atë dashuri, pasion e këmbëngulje që t'u japë fëmijëve e të rinjve, nxënësve të kësaj shkolle gjithçka nga përvoja e saj, nga virtuoziteti i saj. Me këta nxënës të talentuar është paraqitur me dinjitet në konkurse në Tiranë e Kosovë dhe ka fituar çmime e ka marrë vlerësime maksimale.

Ne, dibranët, krenohemi kur shohim që talente të tilla lindën e u përkunden në një djep plot tradita jo vetëm në qëndresë e trimëri, por edhe në art e kulturë. Ndjehemi kryelartë që nga gjiri ynë mbijnë e rriten talente që mbushin skenën e i japin kënaqësi jetës. Krenohemi dhe gëzojmë kur shohim bijtë dhe bijat tona përkrah artistëve më të shquar të vendit, siç e pamë ditë më parë dhe Edlirën, cucën dibrane duke luajtur solo në violinçel dhe duke ekzekutuar vepra të mëdha muzikore. Në këtë veprimtari artistike morën pjesë pedagogë të akademisë së Arteve Gjovalin Lazri, Astrit Selita e Aristidh Prosi. Për të tillë portrete e profile artistike të kompletuara, për të tillë talente, për të tillë njerëz të rrethua me mirënjohja ka pse jo edhe me dashuri.

Dibër e Madhe - *Artin Spahiu, drejtor i Qendrës për Kulturë*

Dyert e hapura për aktivitete kulturore

Artin Spahiu, drejtor i Qendrës për Kulturë në Dibër të Madhe është kuadër i emëruar në janar të këtij viti, i cili me ardhjen e tij solli një frymë të re të organizimit dhe veprimit. Synim i imi është që në Qendrën për Kulturë të krijoj kushte dhe ambiente ku të rinjtë dibranë të mund ta kalojnë pjesën më të madhe të kohës së lirë në mënyrë të dobishme e të kulturuar dhe larg kafeterive dhe sjelljeve devijante.

I pyetur për qëllimet e tij në shtimin e aktiviteteve kulturore në Dibër të Madhe, drejtori Artin Spahiu, thekson se: "Përpjekjet e mia janë që kjo qendër kulturore të jetë e hapur për të gjithë ata që me punën e tyre dëshirojnë ta pasurojnë jetën kulturore në qytet, duke shtuar se në frymën e kësaj dhe në mungesë të mundësive financiare, shfrytëzuesve për aktivitetet në ambientet tona nuk u marrim para.

Në pyetjen se çfarë risish kanë ndodhur brenda këtyre muajve, Spahiu, thotë se:"Pikësynim janë investimet. Aktualisht kemi bërë ripërtëritjen dhe vënien në funksionim të plotë të bibliotekës duke e pasuruar me 500 tituj të rinj të të gjitha zhanreve. Në këtë kuadër kemi krijuar edhe ambientet për lexuesit e librave dhe të shtypit, si edhe internet leximoren të pajisur me kompjuterë.

Kemi bërë rikonstruksionin e ambienteve të pingpongut që nuk funksiononin për më shumë dekada. Këto ambiente ia kemi lejuar t'i shfrytëzojë Klubit të pingpongistëve të Dibrës sç Madhe .

Kemi vendosur që ambientet tona për aktivitetet e tyre të mund t'i shfrytëzojnë pa asfarë pagese të gjitha OJQ-të dhe shoqëritë kulturore dhe artistike.

Në Qendrën për Kulturë në Dibër të Madhe janë zhvilluar një serë aktivitetesh kulturore. Boris Trajanov, maestro I operës dha koncertin e tij para publikut dibran, Shoqëria kulturore "Teuta" nga Tetova dha koncertin e saj me këngë qytetare. Janë hapur ekspozita të piktorëve. Janë organizuar debate rinore për migrimin, drogën dhe arsimin sipëror. U organizuan aktivitete me rastin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës. U shënua Festa tradicionale Rome. Për nder të Ditëlindjes së Muhamedit a.s. u organizuan ligjerata dhe një koncert tematik fetar. Në galerinë e arteve u organizua mbrëmja rinore. Janë organizuar koncerte të këngëtarëve të rinj. Janë mbajtur aktivitete politike dhe kulturore të të gjitha partive politike. U organizua edhe panairi I botuesve të librave. Me mbështetjen e Qendrës për Kulturë u mbajtën edhe tri premierat e shfaqes me gjimnazistë nga Dibra e Madhe "Shi në Plazh". Ndërkaq do të intensifikohet edhe më shumë bashkëpunimi me Qendrën për Kulturë të Dibrës së Vogël-Peshkopisë në Shqipëri.

MINISTRIA TË NA NDIHMOJË FINANCIARISHT

Drejtori Artin Spahiu nuk nguron të flasë edhe për problemet me të cilat po ballafaqohet kjo qendër për kulturë, duke thënë se," përkundër shumë përpjekjeve që Qendrës për Kulturë në Dibër të Madhe t'i rikthehen mjetet financiare në shumë prej 25 mijë euro, të ndaluara në mënyrë të padrejtë nga Ministria për Kulturë e Maqedonisë në nëntor të vitit 2008. Kjo tregon shkelje flagrante të afateve për realizimin e projekteve, sepse mjetet e dedikuara mund të shfrytëzohen brenda përfundimit të vitit kalendarik, përkatësisht deri më 31 dhjetor 2008. Për fat të keq këto mjete nuk arritëm ti rikthejmë pasi kërkesa jonë në Komisionin për kulturë të shkallës së dytë pranë Qeverisë së Maqedonisë nuk u morr parasysh, edhe pse në kërkesën tonë pasqyruam sasi të madhe të borxheve që i kemi si institucion. Në arsyetimin e Ministrisë për Kulturë, përmendet se gjoja gjatë aktiviteteve të kësaj qendre për kulturë në vitin 2008 nuk ka patur një ritëm të mjaftueshëm për realizimin e projekteve nga paraardhësi im.



Në foto" Artin Spahiu

Këtu nuk duhet lënë pa përmendur se ish ministrin e Maqedonisë për kulturë, i cili këtë shumë prej 25 mijë euro në mënyrë joligjore e ka depozituar në xhirollogarinë personale të Qendrës për Kulturë në Dibër, edhe pse pjetet e programore duhet të depozitohen në xhirollogarinë buxhetore të Qendrës për Kulturë. Kjo sjellje e ish ministrit për kulturë ka patur për qëllim frenimin e punës së këtij institucioni kulturor, sepse gjatë vitit 2008 janë miratuar vetëm 6 projekte me vlerë tejet të minimizuar të buxhetit,nga 13 projekte të aplikuara në Ministrinë për Kulturë, tha në fund drejtori Artin Spahiu, i bindur dhe me shpresë që Ministria për Kulturë e Maqedonisë do të gjejë mundësi për t'i plotësuar kërkesat e kësaj qendre kulturore në Dibër të Madhe, pasi gjendet në prag të shumë aktiviteteve kulturore në pritje të afër 6000 mërgimtarëve që gjatë pushimeve verore do ta vizitojnë vendlindjen e tyre, Verën Kulturore-Dibra 2009, Festivalin "Teatri Shqiptar në Maqedoni-Dibra 2009 dhe shënimin e 100-Vjetorit të Kongresit të Dibrës.

Rexhep TORTE

Me rastin e 25 vjetorin e lindjes dhe 1 vjetorin e vdekjes.

Një vit pa Landin

Nga: **SHAQIR SKARRA**



Në fakt emrin e ka Mevlan, por në qytetin minator të Bulqizës të gjithë e kanë thirrur Landi. Kështu e kujtojnë miq e shokë edhe sot pas një viti që nuk e kanë më në gjirin e tyre. Ndaj u mblodhën edhe njëherë të gjithë bashkë në shtëpinë e Afrim Shirës. Miq e të afërm, shokë e qytetarë të Bulqizës. Si atë ditë prilli kur plasi gjama, kur kjo shtëpi e vogël përcolli për në banesën e fundit djalin e madh Mevlanin. Tani u mblodhën bashkë për të kujtuar këtë përvjetor të hidhur. Kishte ardhur dhe nusja e Landit veshur me të zeza, Esmeralda. Edhe pse kishte kaluar një vit lotët ende nuk u ishin tharë. I vetmi që ende nuk kuptonte në këtë shtëpi ishte Mevlani shtatë muajsh që lozte me kukulla. Ai erdhi në jetë tre muaj pasi i vdiq babai, ndaj ia lanë edhe emrin Mevlan. Afrimi kishte përballuar edhe tragjedi të tjera dhe ishte kalitur disi por vdekja tragjike e djalit Mevlanit e ka dobësuar shumë, megjithatë nuk jepet karshi gruas dhe fëmijëve të tjerë. Landi nuk ishte vetëm djali i madh i tij por dhe shoku më i afërt që konsultoheshin për çdo gjë bashkë. Edhe kur vendosën që t'i ktheheshin biznesit, ashtu babë e djalë bashkë morën një vendim të tillë. Landi u lind në Shumbat por u rrit dhe u arsimua në këtë qytet të bukur strehuar mes maleve. E mësoi herët se sa e vështirë ishte jeta në këtë qytet pasi Afrimi kishte një jetë të tërë që punonte në zgafellat e nëntokës së Bulqizës. Sa e sa herë e kishte lënë Landin në shtratin e ngrohtë, mes ëndrave të bukura të natës dhe vetë ishte larguar për në turnin e tretë. Vetëm kur rrezet e diellit preknin majën e Dhoksit Landi zgjohej e hidhte vështrimin tej nga dritarja në pritje të babait minator. Dhe pikërisht kur sapo kishte mbushur 24 vjeç, kur priste të bëhej baba, kur shtëpia priste më shumë, një aksident automobilistik ia këputi ëndrat në mes. Nusja Esmeralda ishte shtatëzënë, ishte në muajn e tretë. Prisnin të gjithë në këtë familje minatori që një fëmijë të vinte në jetë…Atë mëngjez prilli Landi doli herët nga shtëpia meqëllim që do të kthehej shpejt si çdo ditë. Por fati këtë ditë të zezë prilli nuk ishte me të, nuk ishte as me Afrimin dhe nënë Shatulen, nuk ishte as me Esmeraldën, as me krijesën e vogël tre muajsh në barkun e saj, as me vëllezërit e motrat, as me shokët e shumtë që kishte Landi në qytetin e Bulqizës. Aksidenti automobilistik ishte kundër të gjithëve. Landi Shira iku si pa kuptuar nga kjo jetë për t'u kthyer si një engjëll se vetë ishte engjëll. Qyteti i vogël e gjama shpërtheu portat e të gjithë bulqizakëve atë ditë prilli. Qytetarët vërshuan si ortek ende pa ardhur në shtëpi trupi i pa jetë i Landit. E pikërisht tashmë është mbushur plot një vit që në shtëpinë e thjeshtë të Afrim Shirës mungon Landi. Ky përvjetor u përkujtua mes dhimbjes e lotëve të shumtë por një rreze drite shkëlqente në këtë shtëpi të vogël. Kishte lindur Mevlani i vogël i cili ishte në barkun e nënës kur iu vra aksidentalisht baba. E ndaj i vendosën këtë emër që sa të rrojnë ta kujtojnë djalin e tyre Afrimi e Shatulja. Ai sot i ka mbushur shtatë muajt e akoma nuk di të belbëzojë por fakt është se përkëdheljet e babës do ti mungojnë gjatë gjithë jetës. Për të do të bëhet baba gjyshi i tij Afrimi i cili do të mundohet që t'ia lehtësojë sado pak këtë humbje të madhe. Megjithatë Afrimi pret edhe njëherë që shtëpia t'i mbushet plot. Po vjen qershori e djali i tij që nuk jeton më po të ishte gjallë do të festonte 25 vjetorin e lindjes. Ku dihet mes miqve e shokëve ky përvjetor do të kujtohet.

Fjalë mirënjohje për Magjistër Rruzhdi Lata



Shembulli dhe veprimtaria atdhetare, fetare e kulturore e Magjistër Rruzhdi Lata rrezaton në Dibër. Rruzhdiu u lind më 6 maj 1953 në fshatin Hame, në Dibër të Madhe në një familje me tradita të shquara atdhetare e fetare. Pas shkollimit fillestar në vendlindje vazhdoj shkollimin në medresenë e Alaudinit në Prishtinë, si dhe kreu me sukses fakultetin filologjik, grupin e gjuhëve orientale në universitetin e Kosovës,ku do te vazhdojë edhe shkallën e tretë të studimeve në degën e letërsisë shqiptare. Mbrojti masterin me temën e realitetit historik të poemës "Qerbelaja" të Naim Frashërit.

> Kurdoherë pranë njerëzve me zellin e pashuar për fenë ,për atdheun, për traditat dhe papërtimin. Magjistër Rruzhdi Lata është sa i thjeshtë aq edhe i përkushtuar, sa i urtë aq edhe studiues, fisnik e dashamir, gjithnjë pranë njerëzve, pranë jetës

Punimet shkencore të kryera nga magjistër Rruzhdi Lata janë të shumta si përkthimi i romanit të Sami Frashërit "Dashurija" e Telatit me Fitnetin së bashku me magjistër Mehdi Polisin(nga turqishtja. Zotëron gjuhët e huaja si arabisht turqisht dhe gjuhët sllave. Ka përkthyer veprën "Bashkëshortësia) islame" , nga arabishtja "Buhariun"etj. Ka bërë punime studimore si "Haxhi Vehbi Dibra kryetar i senatit të parë shqiptar", botuar në gazetën "Flaka e vllazërizimt", në prill 19922 (Me 8 vazhdime) ."Haki Sharaki-mësues i popullit" botuar në të përditshmen "Flaka e vllazërimit" në gusht 1993 (me 4 vazhdime) "Fuad Delira jeta dhe vepra", botuar në gazetën "Flaka e vllazërimit" në shtator 1993 shkroi për "Said Najdenin". Shkroi "Hoxhallarët e Dibrës" Shkup 1994 . "Kontributi i hoxhallarëve të Rekës së Dibrës" botuar në librin e punimëve të simpoziumit e "Dibra dhe etnokultura e saj" 1995. Rruzhdi Lata i talentuarka punuar gjatë si asistent në procesin mësimor për letërsinë turke për 12 vjet me radhë.Në vitin 1991 dhuna serbe dhuna serbe e largoj Rruzhdi Latën nga Hama kështu që punën e vazhdoj në fakultetin filozofik ku vetë shqiptarët janë të detyruar ta angazhojnë jashtë objektevë përkatëse. Në vitin 2002 përkrtheu thënie profetike të "Sahi Yll Buhariu " gjithsejt dhjetë. Kurdoherë pranë njerëzve me zellin e pashuar për fenë, për atdheun, për traditat dhe papërtimin. Magjistër Rruzhdi Lata është sa i thjeshtë aq edhe i përkushtuar, sa i urtë aq edhe studiues, fisnik e dashamir, gjithnjë pranë njerëzve, pranë jetës. Ai ka shkruar me kompentencë e passion për figurat e ndritura të vendit tonë. - Do të ishtë mëkat, thotë magjistër Rruzhdi Lata- që në aktivitetet qofshin fetare, qofshin kombëtare të mos flasim për Hafiz Ali Korçën pjesëmarrës në Kongresën e Dibrës që kërkonte me çdo kusht që proçesverbali i kongresit të mbahej në gjuhën shqipe. E në Kongresin e Manastirit Rruzhdiu ngre lart vlerat e Gjergj Fishtës . Magjistër Rruzhdi Lata midis të tjerave na ka dhënë studimin me vlerë " Roli i predikuesve fetarë në Kongresën e Dibrës " ku pasqyron me saktësi rolin e madh atdhetar, qëndresën edhe veprimtarinë në dobi të çështjes kombëtare e të arsimit, të figurave të ndritura dibrane.K anë luajtur një rol sa fetar aq edhe kombëtar, shkruan Rruzhdi Lata figura të tila të njohura si Haxhi Vehli Dibra, Hafiz Sherif Lëngu, Hafiz Ali Korça. Në vitin 1995 përfundon një specializim në Stamboll.Vite më vonë Magjistër Rruzhdi Lata do ta shikojmë në të gjitha aktivitetet kulturore, shkencore, fetare dhe arsimore.Sa e sa herë në simpoziume të ndryshme zëri i tij do të dëgjohej me kureshtje nga të tjerët.Dhe jo vetëm në Maqedoni por dhe jashtë saj Rruzhdiu ka qenë i ftuar të marr pjesë në simpoziume shkencore si në Sarajevë, Gjermani, Austri, Zvicër, SHBA etj.

-Jam ende i ri do të shprehet Rruzhdiu, them se kam për të dhënë edhe më shumë për vendin tim.Do ta justifikoj me punë dhe vetëm me punë këtë mirënjohje dhe respekt që kanë të tjerët për mua.

Mevlud Buci

Lulishtar në Oborrin e Zogut dhe Bllokun e Enverit



Ai sot nuk jeton më. Ka tre vjet që ka vdekur por historia e tij e rrallë është ende në kujtesën e të gjithë dibranëve që e kanë njohur nga afër. Han Tota nga fshati Blliçe, i rritur jetim, në moshë të vogël u largua nga fshati i tij i lindjes dhe u vendos në Tiranë duke punuar tek një pronar tiranas. Pas punës Hani ishte i dhënë shumë pas luleve ku mjedisi i jashtëm në shtëpinë e pronarit u zbukurua me lule të ndryshme sipas shijeve të dibranit jetim. Kjo nuk mund të qëndronte gjatë pa rënë në sy të të tjerëve në ato vite pasi dhe Tirana kishte një shtrirje të vogël e njohja ishte e lehtë mes të gjithëve.

Kështu emri i Han Totës filloi të lakohej shpesh edhe në qarqe intelektuale por dhe në rangje më të larta. E mori vesh dhe vetë mbreti Zog se në Tiranë ishte një lulishtar profesionist. Mbreti dërgoi njerëz dhe e mori dibranin në Oborrin mbretëror. Ishte një privilegj i madh në ato vite të punoje në Oborrin Mbretëror sidomos për një jetim nga Dibra siç ishte Han Tota por ja që edhe fati shpesh herë jetimëve u prin për mbarë. Hani ra shpejt në sy për mirë tek Zogu për punën me cilësi që bënte dhe për zgjuarsinë që kishte. Me atë trupin e tij të njomë, jetimi i Dibrës nuk ulej gjatë ditës.

Ashtu me shatë, me gërshërë e ku e ku edhe me duart e tij rrinte pas luleve.

Han Tota do të ishte i pranishëm mes atyre qindra e qindra të ftuarve në dasmën e madhe të Mbretit Zog me austro-hungarezen e bukur Geraldinë. Hani ishte edhe punëtor por dhe i zgjuar. Pushtimi fashist i vitit 1939 për Han Totën nuk do të ishte i lehtë. Zogu bashkë me shpurën e tij u largua nga Shqipëria, e miku i tij, lulishtari që kishte punuar me pasion prej kaq vitesh do të përjetonte dhe çaste të vështira ekonomike por dhe psikologjike në atë periudhë kohe. Përsëri gjeti punë. Profesioni i tij ishte i bukur dhe njerëzit kishin nevojë për Hanin. Pas çlirimit do t'i vinte një tjetër ftesë, tamam si atëherë kur e ftonte Zogu në Oborrin e tij por tashmë e kërkonin si lulishtar në Bllokun që sapo kishte nisur të rrethohej. Punoi për gati pesë vite në Bllokun e ri mes udhëheqjes komuniste.

Këtu Hani tashmë i pjekur mirë dhe jo si atëherë në moshë të njomë, pa me sytë e tij prapaskenat që kurdiseshin, korrupsionin që kishte mbërthyer udhëheqjen. I bëri publike këto por për të filloj dhe survejimi si njeri i padëshiruar dhe i dyshimtë. U largua vetë nga Tirana dhe iku në Blliçe për të jetuar përfundimisht. Kjo ikje e Hanit nuk mund t'ju pëlqente të tjerëve, ndaj në vitin 1975 arrestohet dhe dënohet me 25 vjet burg.

Këtë fat do të kishin dhe dy djemtë e tij Hasani dhe Xhemali që të tre së bashku bënë mbi 50 vite burg. Han Tota lirohet nga burgu vetëm në vitin 1991.

Tashmë i lodhur nga vitet e burgut e braktisi profesionin e tij të lulishtarit. Fundja ishte pikërisht ky profesion që i kushtoi atij dhe dy djemve një gjysmë shekulli burg komunist.

SHEMSI DACI

botime

Xhafer Martini boton librin "Optika e Schmitt-it për Skënderbeun", ku nxjerr në pah burime të reja, origjinale dhe autentike mbi Skënderbeut, origjinën, luftrat dhe drejtimin e shtetit të Arbërit prej tij.

Cili ishte shteti i Skënderbeut?

Nga **XHAFER MARTINI**

Të bën përshtypje një hartë që ka vënë autori në faqen 187 të librit të tij ku shënohet shteti i Skënderbeut në verë, sepse, territori që kishte nën sundim Skënderbeu, dimrit bëhej më i gjerë, për arsye se ushtria turke tërhiqej. Kjo hartë nuk dëshmohet se cilit vit i përket, por në të dallojmë që territori që zotëron Skënderbeu në verë të x viti përmbledh një pjesë të krahinës së Matit dhe një pjesë të krahinës së Dibrës. Madje, edhe këto dy krahina qëndrojnë të veçuara, duke lënë të kuptohej që diku, midis tyre, ka toka të pushtuara nga turqit. Dibra lidhet me Matin me zonën e Katër Grykëve, pra, përmes një terreni malor; terreni është i tillë edhe nga ana Matit. Nuk mund ta mendosh që të kishte ndërmjet këtyre dy krahinave një rrip toke të pushtuar nga turqit. Por, sidoqoftë, kjo nuk është kryesorja.

Habia më e madhe është kur shikon që edhe Kruja është jashtë shtetit të Skënderbeut kur dihet që ajo asnjëherë, sa qe gjallë Skënderbeu, nuk ra në duar të turqve edhe pse kjo qe dëshira më e madhe e disa sulltanëve, që nuk e kursyen ushtrinë dhe asgjë për marrjen e saj. A nuk është ky një subjektivizëm i theksuar i autorit të librit mbi Skënderbeun? Pse të mos ia japim në hartë Skënderbeut ato vende që ai i ka marrë me shpatë e me gjak?

Është vështirë të saktësosh kufijtë e shtetit të Skënderbeut, se, për shkak të gjendjes së përhershme të luftës, vërtet ato ishin të lëvizshëm. Duke u mbështetur kryesisht në autorët e vjetër, në këtë shkrim kemi për qëllim të theksojmë se, megjithatë, shteti i Skënderbeut ishte shumë herë më i madh nga ai që projekton Schmitt-i në hartën e tij, sidomos kjo duhet thënë për fazën e parë të këtij shteti. Marin Sirdani shkruan se "Posë krahinës së Matit, të Kurbinit, të dy Dibrave t`Arbnit, që Skënderbeu i pat trashgim prej t`et, ai i shtoi shtetit të tij edhe fushën e Mokrenës, disa katunde në distriktin e Shkodrës, krahinën e Beratit e disa vise të princisë së Kaninës". Ky ka qenë një realitet se vërtetohet edhe nga fakti që sulltani i dërgon një ambasador më 1444 Skënderbeut, të



cilit i kërkon që "t`i lëshonte të gjitha viset që nuk i kishte pasë i ati. Skënderbeu i gjegjet se arsyeja e lypte që t`i zotëronte ai ato vende të krishtena, edhe pse s`kishin qenë t`et, mbasi u kishin përkitë princëve të krishtenë, e ai vetë me fuqi të armëve i kishte shtijë në dorë". Në këtë kohë për të cilën flasim, edhe Sfetigradi ishte në dorë të Skënderbeut. Ambasadori truk i kërkon Skënderbeut, sikur pohojnë edhe Barleti, Frangu e Anonimët, që "me fjalë të Sulltanit lypte t`iu paguajshin damet e bame nënshtetasve të Turqisë, t`iu lironte Sfetigradin me dy Dibrat, distriktin e Mokrenës e disa kështjella që kishte mposhtur e t`u detyronte me rrudhë mbrenda rrethit t`atij shteti që kishte qeverisë i ati para se me vdekë", megjithëse, siç e kemi parë më lart, edhe zotërimet Gjon Kastriotit ishin shumë më të mëdha sesa ai që projektohet si shtet i Skënderbeut në hartën e Schmitt-it. Deja dhe fshatrat përreth ishin prona të Lekë Zaharisë, që, pas vrasjes së tij nga Lekë Dukagjini, i mbetën të shoqes, por asaj ia rrëmbyen shkodranët në emër të Venedikut dhe si pronë të tij. Skënderbeu nuk kishte, si duket, ndërmend të ndërhynte, por ai u shty prej princave shqiptarë, që t`ia priste Venedikut rrugën e mësymjes së mëtejshme drejt tokave të Arbërit. Anën e Venedikut e mbanin vetëm Lekë Dukagjini, Pjetër Spani e Gjergj Dushmani. Prijësat e tjerë ishin me Skënderbeun dhe me këmbënguljen e tyre Heroi ia mori Dejën Venedikut, por pastaj ia lëshoi vetë, duke e shkëmbyer me "një copë vend më të madh anës Drinit, të quejtun Buzëgjarpni, edhe do t`i paguante 1400 dukatë... Frangu thotë se toka që iu lëshua Skënderbeut nga Venediku në shkëmbim të Dejës "zinte fill nga bregu i Drinit, buzë Shkodret, e mbaronte në vendin e quajtun Buzëgjarpni, i cili ishte shumë ma i dobishëm për Skënderbeun se sa distrikti i Dejës". Krahina e Beratit dhe Berati vetë me kalanë e tij ishin pronë e Teodor Koronë Muzakës, i cili nuk kishte trashëgimtar në linjën mashkullore, prandaj ia la me testament këto vise Skënderbeut për meritat që kishte në formimin e shtetit shqiptar. Kur ishte duke vdekur Muzaka, Skënderbeu çoi Pal Maneshin me ushtri me marrë në dorëzim kalanë e Beratit. Dhe, në të vërtetë, dorëzimi u bë dhe Maneshi e mori kalanë, por pashai i Gjirokastrës, duke përfituar prej shkujdesjes së Palit, në krye të një ushtrie të madhe, hyri befasisht në kala duke zënë rob Pal Maneshin e Teodor Koronë Muzakën. I pari u lirua për pesëqind dukatë, kurse i dyti, ngaqë nuk e kishte shumën që i kërkohej, e ngritën nga shtrati i vdekjes dhe e varën në mes të qytetit. Prej asaj dite Berati nuk u mor më nga Skënderbeu, por nuk duhet thënë që nuk e pati qoftë edhe për pak kohë.

Skënderbeu kishte në shtetin e tij edhe zotërimet e Gjergj Arianit Komnenit, që i mori si pajë të shoqes së tij Donikës. Duke u mbështetur tek Tivarsi, Marin Sirdani tregon se si ranë nën zotërimin e Skënderbeut edhe tokat e Pultit të poshtëm. "Për Shpanët dihet prej Tivarsit, - shkruan Sirdani, - se tuj pas dekë kah mbarimi i nëntorit 1454, Pjetër Shpani, princi i Pultit Poshtëm, u pështjellue vendi për shkak të bijve që nuk binin në godi për trashëgim. Ipeshkvi i Drishtit, Pjetër Ejllori, çoi e grishi Skënderbeun, që, si kryetar i Lidhjes, të vinte me i vu kapak asaj degame. Ky me t`marrë lajmin, udhëtoi me një pjesë ushtrijet që kishte në Dibër e kaloj në dhenë e Pultit. Aty, ku me të mirë e ku me kërcënim, për nji kohë të shkurtë, me shumë urti e pa i ba dam njeriut të gjallë, pajtoj e qetësoj atë vend.

Nga se u tha më sipër, arrijmë në përfundimin që shteti i Skënderbeut nuk qe i vogël, ai kishte territorin e mjaftueshëm brenda të cilit mund të bëhej jetë e vërtetë shtetërore, sikur kufijtë të mos ishin të lëvizshëm për shkak të luftës. Por këtu ka rëndësi të theksohet se Skënderbeu nuk sundoi vetëm mbi njerëz, por edhe mbi tokën.

(Marrë nga libri i sapodalë në qarkullim)

9 qershor Skënderbeut vjen në Peshkopi


Të martën më 9 qershor 2009, qyteti i Peshkopisë do mbipopullohet. Në sheshin kryesor të saj, para Pallatit të Kulturës, do përurohet shtatorja e Skënderbeut, e cila së bashku me piedestalin ku do ngrihet do të jetë 4.8 metra e lartë.

Burime nga grupi organizator bëjnë të ditur se, shtatorja e hedhur në bronx në Bullgari, është nisur për në atdhe. Gjithashtu, bashkia e Peshkopisë po merr masat për organizimine ceremonisë, mes të cilave edhe një koncert më artistë më të njohur dibranë.

Shatorja e Skënderbeut është bërë nga skulptori i njohur, Dekani i Fakultetit të Arteve, Sadik Spahija.

Por, ai që e ka ndjekur çdo hap, duke qënë edhe ideatori e sponsorizuesi i ndërtimit të shtatores së heroit tonë kombëtar, është biznesmeni dibran, Z. Zaim Krosi. Kur të tjerët shpifin me historira për të ulur vlerat e Skënderbeut, Krosi gjen energjitë që burojnë nga dashuria për atdheun, ta ngrejë Skënderbeun si askund në botë, 4.8 metra në mes të dibranëve.

BOTIME TË REJA TË AUTORËVE DIBRANË





Pajtohuni në gazetën "Rruga e Arbërit"

Tel. (04) 22 33 283.
E-mail: rrugaearberit@gmail.com.
Numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit.
Për ata që duan që gazeta t'ju shkojë me postë në shtëpi, ju lutem konfirmoni në redaksi adresën e saktë

www.dibra.org